

Faqe 4 Presidenti amerikan i drejtohet kombit për të deklaruar fitoren kundër "RFJ"-së

# Clinton: "E kemi arritur një fitore për një botë më të sigurt"

"Kemi bërë atë që duhet, e kemi bërë si duhet dhe do ta kryejmë punën", ka deklaruar Clintoni

Faqe 4

# Refugjatët: "Kemi besim në Zotin dhe NATO-n"


KOHA Ditore

Numri 711
E shtunë 12 qershor 1999
Samstag 12 Juni 1999
DEM 2,00; [illegible]; BEF [illegible];
LIT 3100; [illegible] 2,50; [illegible] 15,00;
CZT [illegible]; [illegible] 270; £ 1,00


Gratis Free Copy

Faqe 10 Kolumne

Janusz Bugajski: Nga kryeqyteti i botës

# A do të mbijetojë Milosheviqi?

Edhe pse me finokërinë e tij të zakonshme, fshikatarinë dhe pamëshirësinë, Milosheviqi e mbijetoi luftën, ka shumë pak gjasa që ai ta mbijetojë paqen tashti

"Koha ditore" mëson planin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë

# NATO në Kosovë

Burimet në selinë e NATO-s në Bruksel dhe nga ushtarakët në Shkup, të premten, thanë për "Kohën ditore" se "është imperativ që, posa të fillojë hyrja, brenda ditës të arrihet në Prishtinë" - Pas Prishtinës, trupat e NATO-s shkojnë së pari në Pejë, pastaj në Mitrovicë - Sa u përket Prizrenit dhe Gjakovës, ekzistojnë dy plane: njëri është që atje të bëhet hyrja e marinsave amerikanë nga territori i Shqipërisë, ndërsa tjetri që francezët dhe britanikët të fillojnë marshimin prej drejtimit të Pejës dhe kufirit me Maqedoninë





Sekretarja e Shtetit amerikan viziton të dëbuarit në Stenkovec

# Albright: "Do të ktheheni në shtëpi"

• "Kemi luftuar, që këta njerëz të kthehen në shtëpitë e tyre. Në kemi fituar, serbët kanë humbur", tha ajo gjatë qëndrimti të saj në kamp. Në një intervistë-dhënë televizionit amerikan ABC, Albright tha se përshtypja e saj nga kjo vizitë është se "këta njerëz e kanë pranuar vuajtjen e tyre me shumë kurajo"



**"Koha ditore" mëson planin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë**

# NATO në Kosovë

**Burimet në selinë e NATO-s në Bruksel dhe nga ushtarakët në Shkup, të premten, thanë për "Kohën ditore" se "është imperativ që, posa të fillojë hyrja, brenda ditës të arrihet në Prishtinë" - Pas Prishtinës, trupat e NATO-s shkojnë së pari në Pejë, pastaj në Mitrovicë - Sa u përket Prizrenit dhe Gjakovës, ekzistojnë dy plane: njëri është që atje të bëhet hyrja e marinsave amerikanë nga territori i Shqipërisë, ndërsa tjetri që francezët dhe britanikët të fillojnë marshimin prej drejtimit të Pejës dhe kufirit me Maqedoninë**

*AUGUSTIN PALOKAJ*

SHKUP/BLLACE, 11 QERSHOR - Në kohën kur ky numër i gazetës të jetë në duart tuaja, sipas të gjitha gjasëve, trupat e para të NATO-s do të jenë, më në fund, në Kosovë. Sipas burimeve të aleancës në Bruksel dhe këtu në Shkup, tërheqja e trupave serbe, tash për tash, po shkon "ngadalë, por sipas planit". Tërheqje më të madhe ka patur nga rajoni i Podujevës dhe nga Prishtina, por kryeqyteti i Kosovës do të jetë edhe disa ditë "stacion transitor" i njësive ushtarake, policore, paramilitare dhe i forcave tjera serbe gjatë tërheqjes.

Sipas njoftimeve të deritashme që i kanë dhënë zyrtarët e NATO-s në Shkup, ku tani punon zyra e shtypit, ka disa vonesa në nisjen e hyrjes së trupave në Kosovë. Zyrtarët e NATO-s lënë të kuptohet se "problem kryesor shkaktojnë fushat e minuara".

Komandanti i forcave të NATO-s për Kosovën, gjenerali britanik Mikel Jackson, ka thënë në Shkup se "pala jugosllave, deri më tash, është duke u dhënë informata të duhura, por ushtarët e aleancës nuk do të bazohen tërësisht në informatat serbe lidhur me fushat e minuara".

Sipas fjalëve të gjeneralit Jackson, "Ushtria jugosllave dhe MUP-i i Serbisë kanë vënë mekanizma të detajuar lidhjesh me KFOR-in dhe janë duke dhënë informata për minat, por as ata nuk e dinë saktësisht për secilin vend".

Sipas kësaj, minat janë ndër shkaqet kryesore që ndikojnë në shpejtësinë e vendosjes së trupave të NATO-s nëpër sektorët në Kosovë.

## NATO-ja merr kufirin, pastaj niset në Prishtinë

Burimet në selinë e NATO-s në Bruksel dhe nga ushtarakët në Shkup thanë për "Kohën ditore" se "është imperativ që, posa të fillojë hyrja, brenda ditës të arrihet në Prishtinë".

Sipas këtij plani, ushtarët e NATO-s në fillim do të marrin postën kufitare në kufirin mes Maqedonisë e Kosovës, do të vendosin vëzhguesit në Grykën e Kaçanikut, dhe do të fillojnë marshin drejt Prishtinës. Trupave do t'u prijnë inxhinierët për deminim me mjetet e tyre, sepse supozohet se ka mina në dy apo tri pika përgjatë rrugës Bllace-Prishtinë. Me arritjen në Prishtinë do të fillonte stacionimi i trupave në kryeqytetin e Kosovës, gjegjësisht, thënë simbolikisht, "do të vihej flamuri" i trupave të KFOR-it.

Zyrtarët e NATO-s kanë thënë se nuk do të tolerojnë asnjë zhagitje të procesit të tërheqjes së trupave serbe nga Kosova dhe kanë ripërsëritur se gjenerali Jackson mbanë të drejtën që të kërkojë rifillimin e sulmeve



ajrore kundër pozicioneve serbe në rast se nuk i përmbahen marrëveshjes ushtarake.

Sipas planit të NATO-s, destinacioni i parë nga Prishtina do të ishte Peja. Ata pohojnë se pas hyrjes në Prishtinë do të fillohet me pastrimin e rrugës Pejë-Prishtinë që do të jetë me të vërtetë një sfidë e madhe duke patur parasysh luftimet e ashpra që janë zhvilluar në afërsi të Komoranit, në Kijevë dhe në Klinë.

Qëllimi është që pas marrjes së Pejës të organizohet urgjentisht dhënja e ndihmave për të zhvendosurit dhe të krijohen kushte për normalizim të trafikut vetëm për trupat e KFOR-it dhe për organizatat humanitare. Në fazën e tretë të pastrimit të rrugëve kryesore që do t'i pastrojnë ushtarët e NATO-s është rruga Prishtinë-Mitrovicë.

Sa u përket dy qyteteve tjera të mëdha të Kosovës - Prizrenit dhe Gjakovës - ekzistojnë dy plane: njëri është që atje të bëhet hyrja e marinsave amerikanë nga territori i Shqipërisë, ndërsa tjetri që francezët dhe britanikët të fillojnë marshimin prej drejtimit të Pejës dhe kufirit me Maqedoninë.

## Kosova ndahet në pesë sektorë - të gjithë nën komandën e NATO-s

Gjenerali Jakson ka përsëritur në Shkup se "ekzistojnë ndarje të sektorëve në Kosovë" dhe se "ato harta që kanë qarkulluar nëpër shtyp nuk janë larg së vërtetës".

Fjala është për ndarjen e sektorëve mes pesë fuqive më të mëdha të NATO-s, ashtu siç e pat botuar "Koha ditore" para tre muajsh, gjatë kohës së mbajtjes së konferencës së Rambouilletit.

Sipas kësaj, pas hyrjes nismëtare të trupave, sektorët do të ndahen në atë mënyrë që Britania e Madhe të ketë Kosovën Qendrore dhe një pjesë të Kosovës Veriore, me qendër në Prishtinë. Numri i trupave britanike nga 13.000, sa është konfirmuar që do të ketë në Kosovë, do të rritet me siguri deri në 19.000, gjë që do ta bëjë këtë shtet më të pranishmin në Kosovë.

Gjermania do të jetë në vendin e dytë - tash për tash me 8.500 trupa, dhe do ta ketë sektorin dominues të saj në rajonin e Gjakovës dhe të Prizrenit, ndërkohë që në pjesën tjetër të Rrafshit të Dukagjinit, në rajonin e Pejës, do të jenë ushtarët francezë, numri i të cilëve parashikohet të jetë rreth 7.000. Italianët, të cilët, me 2.500 trupa do të jenë më pak të numërt sesa të tjerët, do të kenë udhëheqjen e sektorit me qendër në Mitrovicë, ndërsa atyre, sipas të gjitha gjasëve, do t'u bashkohen 2.000 holandezë dhe diç më shumë se 2.000 spanjollë.

Amerikanët do të kenë, sipas burimeve, rajonin e Gjilanit, ku do të vendoset pjesa më e madhe e kontigjentiti të tyre që do të numrojë mbi 7.000 ushtarë.

Në kuadër të KFOR-it do të ketë edhe shumë trupa nga vendet tjera të NATO-s, si nga Turqia mbi 1.000, Polonia 800, Belgjika afro 1.000, Kanadaja, etj., ndërsa 10 për qind të trupave do të dërgojnë partnerët e NATO-s, përfshirë Slloveninë, Sllovakinë, Austrinë, Suedinë, vendet Baltike etj.

Ka mbetur të shqyrtohet edhe pjesëmarrja e Ukrainës, si partnere e veçantë, e cila tashmë i ka të gatshme trupat.

Sa i përket Rusisë, NATO-ja pohon se situata është gjithnjë e më shumë duke u sqaruar.

## Rusët nuk kanë para për të paguar ushtarët e tyre në Kosovë

Tashmë kanë filluar kontaktet konkrete mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Rusisë, përmes ndihmëssekretarit Strobe Talbott. Amerikanët e kanë bërë të qartë se nuk do të ketë sektorë të veçantë rus, aq më tepër nuk do të ketë asnjë sektor në Kosovë ku NATO-ja nuk do ta ketë rolin kryesor.

Në anën tjetër, është bërë më se e qartë se vendet e NATO-s dëshirojnë që edhe Rusia të dërgojë trupat e saja në Kosovë, por duhet të rregullohen të gjitha modalitetet.

Gjenerali Jackson, i cili edhe do të komandojë trupat e KFOR-it në Kosovë, ka thënë se "nuk kam asnjë informatë se Rusia ka ofruar ende dërgimin e ndonjë kontigjenti, por kur të jenë gati mund të na bashkohen".

Në anën tjetër, tash kur u vendos që misioni të jetë me mandatin e OKB-së, por jo edhe mision i OKB-së, dhe kur u pa se secili shtet duhet t'i mbulojë shpenzimet e veta e jo të marrin pagesa nga buxheti i OKB-së, doli në shesh edhe problemi i financimit të trupave ruse. Nga ideja euforike që të dërgojnë 10.000 ushtarë në Kosovë, rusët kanë kuptuar realitetin dhe tash përmenden shifra shumë më të vogla.

## Perëndimi paguan ushtarët rusë - Rusia dëgjon Perëndimin?

Megjithëse nuk munden ende të saktësojnë, duket reale që ushtarë rusë në Kosovë të ketë prej 600 deri në 2.000.

Gjithashtu, disa zyrtarë të lartë të NATO-s i kanë thënë këto ditë "Kohës ditore" se "Rusia ka luajur një rol tejet të rëndësishëm në aspketin politik dhe diplomatik, kështu që shtetet perëndimore janë të gatshme t'i ndihmojnë materialisht për të dërguar trupat në Kosovë".

Sipas të gjitha gjasëve, e parashikimet shkojnë në atë drejtim, trupat ruse do të mund të inkorporoheshin në disa sektorë në Kosovë, por më së shumti në sektorin amerikan. Është e mundshme që rusët të jenë nën komandën unike, por mund të ketë edhe lidhje specifike përmes koordinatorit civil për Kosovën të cilin duhet ta emërojë sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anann.

Komandanti i forcave të KFOR-it në Kosovë tashmë i ka të qarta detyrat e tij. Si ushtarak i përkryer ato i definon si "monitorim, verifikim dhe në rast nevoje edhe imponim me forcë të tërheqjes së trupave serbe dhe zbatimin e marrëveshjeve ushtarake".

Qëllimi kryesor, thënë në përgjithësi, është "krijimi i kushteve për rindërtim dhe kthimin e refugjatëve nëpër shtëpitë e tyre", ka thënë në Shkup gjenerali Jackson.

Udhëheqësi i misionit të KFOR-it ka deklaruar se "kthimi nuk do të jetë aq i lehtë duke patur parasysh problemet specifike të shkatërrimeve dhe minave". Ai tha se, megjithëkëtë, "e kupton shumë mirë ndjenjen e refugjatëve të cilët dëshirojnë që menjëherë të fillojë kthimi".

Duke u përgjigjur në një pyetje lidhur me largimin e, siç tha një gazetar, të mbi 200.000 serbëve nga Kosova, gjenerali Jackson tha se "pikë së pari, nuk ka patur asnjëherë informatë se mbi 200.000 serbë jetojnë në Kosovë, por qëllimi i misionit të KFOR-it është që të mbrojë të gjithë qytetarët e Kosovë pa marrë parasysh përkatësinë etnike".

## Jackson, me trupat e para, hyn në Kosovë

I pyetur se kur do të hyjë ai në Kosovë, gjenerali Jackson vetëm është përgjigjur: "Unë e kam kohën dhe orarin tim, ndërsa ju do ta dini këtë kur të ndodhë".

"Koha ditore" mëson se kjo do të ndodhë në ditën kur ju ta keni këtë numër të gazetës në dorë, me ndjenjen së së shpejti do ta lexoni në Kosovë.

Jackson, i cili është në krye të forcave paqeruajtëse të NATO-s, që janë duke hyrë në Kosovë, menjëherë pas tërheqjes së forcave Serbe, planifikon të japë një konferencë shtypi, në Prishtinë, në orën 15:00, të shtunën.

"Gjenerali planifikon të japë një konferencë shtypi në Prishtinë, në orën 15:00", tha një burim nga NATO.

Sapo të stacionohen trupat në Prishtinë, atje do të hapet edhe qendra për shtyp e NATO-s. Tashmë afro 1.000 gazetarë presin në Shkup për të hyrë në Kosovë, ndërsa ata që janë në Prishtinë me akreditime të Beogradit do të duhet t'i ndërrojnë ato me akreditime të NATO-s.

"Koha ditore" do të jetë në Kosovë së bashku me trupat e para të NATO-s.



## Sekretarja e Shtetit amerikan viziton të dëbuarit në Stenkovec

# Albright: "Do të ktheheni në shtëpi"



- **"Kemi luftuar, që këta njerëz të kthehen në shtëpitë e tyre. Në kemi fituar, serbët kanë humbur", tha ajo gjatë qëndrimti të saj në kamp. Në një intervistë-dhënë televizionit amerikan ABC, Albright tha se përshtypja e saj nga kjo vizitë është se "këta njerëz e kanë pranuar vuajtjen e tyre me shumë kurajo"**
- **Duke u folur ushtarakëve amerikanë, Albright u tha: "Vendi që ju do ta çlironi ka kaluar kohë të vështira. E di se kjo nuk është e lehtë për ju. Jemi thellësisht të nderuar që ju do ta bëni këtë. Ju e sillni një histori të re"**

KOHA Ditore *Nebi Qena*

STENKOVEC 1, 11 QERSHOR – Mijëra refugjatë shqiptarë në kampin "Stenkovec 1" u tubuan sot për të prituar ardhjen e sekretares së Shtetit amerikan, Madeleine Albright. Sekretarja Albright, arriti një gjysmë ore pas mesditës në përcjellje të zëdhënësit të Departamentit shtetëror amerikan, James Rubin, dhe ambasadorit amerikan në Maqedoni, Christopher Hill.

Në brohoritjen e të tubuarve, që vazhdimisht brohorisnin "Albright!, Albright!", "USA!" dhe "Rubin!", sekretarja e Shtetit bëri një shëti gjysmorëshe nëpër kamp, duke vizituar disa familje refugjatësh.

"Do të ktheheni në shtëpi. Dhe atje nuk do të jetë kaq nxehtë", u tha Albright disa anëtarëve të një familjeje, tendën e nxehtë të së cilës Albright vizitoi.

Edhe vetë refugjate e dikurshme, Albright përshëndeste të tubuarit duke ngritur duart lart, derisa krahas saj ecnin disa fëmijë të vegjël.

"Kemi luftuar, që këta njerëz të kthehen në shtëpitë e tyre. Në kmei fituar serbët kanë humbur", tha ajo gjatë qëndrimiti të saj në këtë kamp.

Në një intervistë-dhënë televizionti amerikan ABC, ALbright tha se përshtypja e saj nga kjo vizitë është se "këta njerëz e kanë pranuar vuajtjen e tyre me shumë kurajo".

Ajo tha se beson që refugjatët nuk ndiehen të tradhtuar, porse dinë se kanë përkrahes.

"Unë ndjej se përreth ka optimizëm dhe jo ndjenje tradhtie. Kam ndjenjen se këta njerëz e dinë se kanë miq. Mik i tyre është SHBA-ja, e natyrisht dhe NATO-ja".

Me shtimin e gjasave për vendosjen afatgjate të paqes në Kosovë, pas pranimit të "RFJ"-së që të pranojë forcat ndërkombëtare në Kosovë dhe të tërheqë trupat e veta, janë shtuar edhe përpjekjet diplomatike për të bindur kosovarët se duhet të kthehen në shtëpitë e trye, ndërsa kjo nuk do të marrë shumë kohë.

Burime perëndimore pohojnë se bëhet fjalë që shpejti edhe kryetari amerikan Clinton do të vizitojë Shqipërinë.

Forcat paqeruajtëse të NATO-s janë në gjendje gatishmërie për të hyrë në Kosovë, ndërkohë që trupat ruse kanë hyrë në "RFJ".

Zonja Albright, pasi që arriti në Maqedoni dhe dëgjoi raportet se trupat ruse janë duke lëvizur drejt Kosovës, ishte tejet e befasuar.

"Jem befasuar me hyrjen e forcave ruse në RFJ, por kryeministri rus më ka bindur se forcat ruse do të jenë nën kontroll", tha Albright. Por, ajo mori sigurime nga ministri i Jashtëm rus, Igor Ivanov, se lëvizja e trupave ishte vetëm hap preliminiar dhe se rusët nuk do të hyjnë në Kosovë përderisa nuk të dakordohen aranzhimet, tha zëdhënësi i saj, James Rubin. Ai po ashtu tha se rusët e kuptojnë se në Kosovë do të jetë një komandë e unifikuar nën NATO-n dhe rreth 50.000 paqeruajtës.

Gjenerali Michael Jackson e ka informuar zonjën Albright se trupat ruse janë në lëvizje dhe pas asaj ajo bisedoi në telefon me Ivanovin.

Sekretarja e Shtetit amerikan u takua edhe me gjeneralin Mike Jackson, e pas këtij takimi ajo shkoi në bazën Camp Able Sentry, ku ushtarakët amerikanë përgatiten për të hyrë në Kosovë.

Duke u folur ushtarakëve amerikanë, Albright u tha: "Vendi që ju do ta çlironi ka kaluar kohë të vështira. E di se kjo nuk është e lehtë për ju. Jemi thellësisht të nderuar që ju do ta bëni këtë. Ju e sillni një histori të re".

## Telashet e para për forcën paqeruajtëse të Kosovës

# Rusët kërcënojnë marrëveshjen

- **Agjencia beogradase Beta njoftoi se "një numër i konsiderueshëm" i automjeteve, transporterëve dhe kamionëve ka kaluar kufirin ndërmjet Bosnjës dhe "Jugosllavisë", rreth orës 07:30 të premten, ndërsa burimet nga SFOR-i thanë se kontigjenti përmbanë 15-200 trupa**
- **Para takimit të pasuksesshëm të delegacioneve ushtarake të SHBA-së dhe Rusisë, të premten, shefi i delegacionit ushtarak rus, gjenerali Leonid Ivashov, tha se Moska nuk do të "lusë SHBA-në që t'i japë një sektor të posaçëm në Kosovë". Por në qoftë se marrëveshja nuk arrihet Rusia do të "deklarojë sektorin e vet dhe të pajtohet rreth kësaj me palën jugosllave"**
- **Korrespondenti i BBC-së në selinë e NATO-s, në Bruksel, thotë se është kuptuar se ekziston vonimi i hyrjes së trupave të NATO-s - i shkaktuar nga refuzimi i Greqisë që të lejojë forcat amerikane, të cilat ishin në rrugë për në Maqedoni, të zbarkohen në Greqi deri në çastin e fundit**

BEOGRAD, 11 QERSHOR (K.D.) - Grupi i parë i trupave ruse, hyri në "Jugosllavi", të premten në mëngjes, duke hyrë në Serbi nga Bosnja, njoftoi agjencia e pavarur e lajmeve, Beta.

Raporti i Betës u konfirmua edhe nga BBC-ja, e cila shton se hyrja e trupave të NATO-s nga Maqedonia në Kosovë po vonohet dhe pritet të bëhet të premten vonë, apo të shtunën herët.

Agjencia Beta vuri në dukje se "një numër i konsiderueshëm" i automjeteve, transporterëve dhe kamionëve ka kaluar kufirin ndërmjet Bosnjës dhe "Jugosllavisë", rreth orës 07:30.

Në raport u theksua se automjetet, shumica prej të cilave kishin shënjën e KFOR-it - shkurtesë për forcat ndërkombëtare paqeruajtëse në Kosovë - kaluan nëpër Pavloviq Çupria, afër qytetit kufitar të Bosnjës, Bjelinë.

Gjithashtu u tha se ato do të kalonin nëpër Beograd dhe pastaj do të niseshin në jug, për në Kosovë, edhe pse destinacioni i tyre përfundimtar është ende i panjohur. Raporti nuk dha numrin e trupave dhe automjeteve në konvoj.

Zëdhënësi i Ministrisë së Mbrojtjes ruse, tha më herët në Moskë se kishin filluar përgatitjet për dërgimin e trupave në Kosovë por e kishte hedhur poshtë idenë për një dislokim të shpejtë, njofton Reutersi.

Agjencia ruse e lajmeve Interfax ka theksuar se 1.000 trupat e para ruse, mund të nisen për në "Jugosllavi", që të premten.

Burimet nga SFOR-i, forca ndërkombëtare e vendosur në Bosnje dhe nën udhëheqje të NATO-s, thanë se kontigjenti rus ishte i përbërë prej 150-200 trupa, njoftoi AFP.

### Rusët hyjnë në Kosovë për të marrë sektorin e posaçëm?

Rusia është kërcënuar se do të anashkalon NATO-n dhe të vëndosë Marrëveshjen e posaçme paqësore me regjimin e Beogradit.

Kërcënimi është bërë para se delegacionet ushtarake të Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara u takuan të premten, në një përpjekje të pasuksesshme që të kapërcejnë mosmarrëveshjet për rolin e Rusisë në planin paqësor të Kosovës.

Shefi i delegacionit ushtarak rus, gjenerali Leonid Ivashov, tha se Moska nuk do të "lusë SHBA-në që t'i japë një sektor të posaçëm në Kosovë". Por në qoftë se marrëveshja nuk arrihet Rusia do të "deklarojë sektorin e vet dhe të pajtohet rreth kësaj me palën jugosllave".

Pas takimit me të deleguarit amerikanë, gjenerali Ivashov tha se kontaktet ndërmjet delegacioneve ushtarake janë shtyrë "indefinitivisht".

### Talbott takohet me Ivanovin rreth trupave në Kosovë

Sekretarja e Shtetit amerikan, Madeleine Albright, i urdhëroi zëvendëssekretarit amerikan të Shtetit, Strobe Talbott, që të kthehet në Moskë menjëherë. Talbott, i cili kishte qëndruar në Moskë për bisedime rreth pjesëmarrjes ruse në paqeruajtje, ishte në rrugë për në Bruksel.

Në Washington, këshilltari i sigurisë kombëtare, Sandy Berger, tha se është optimist. "Mendoj se do ta rregullojnë këtë".

Agjencia e lajmeve AFP njoftoi se Talbott do të zhvillojë bisedime të paplanifikuara me ministrin rus të Punëve të Jashtme, Igor Ivanov, për të diskutuar mosmarrëveshjet që thellohen lidhur me rolin e trupave ruse në forcën paqësore në Kosovë, deklaroi një zyrtar i lartë rus.

Amerikanët insistojnë në një strukturë të udhëhequr nga NATO-ja, e cila do të mbante nën komandë dhe kontroll të gjitha trupat paqeruajtëse në Kosovë. Rusia tërë kohën është duke kërkuar që të ketë sektorin e posaçëm me ushtarë rusë dhe nën kontroll rus.

Analistë të shumtë në këtë kërkesë shohin mundësinë e ndarjes së Kosovës.

### Vonimi i hyrjes së NATO-s në Kosovë u shkaktua nga Greqia

Arritja e "paqeruajtësve" rusë u bë në çastin kur hyrja në Kosovë e trupave britanike dhe atyre amerikane, të parapara të jenë pararojë të KFOR-it, është vonuar. BBC-ja pohon se hyrja e tyre mund të bëhet të premten vonë apo të shtunën herët.

Njësitet e para janë pritur të kalojnë kufirin e Bllacës në orën 04:00 të mëngjesit të të premtes, por thuhet se disa shtete të cilat kontribuojnë në trupa kanë kërkuar kohë shtesë për përgatitjen e njësiteve.

NATO-ja demanton se hyrja është vonuar, duke shtuar se çdo gjë është duke u realizuar sipas planit.

Megjithatë, korrespondenti i BBC-së në selinë e NATO-s në Bruksel thotë se është kuptuar se ekziston vonimi i hyrjes - i shkaktuar nga refuzimi i Greqisë që të lejojë forcat amerikane, të cilat ishin në rrugë për në Maqedoni, të zbarkohen në Greqi deri në çastin e fundit.

Ndërkohë, Gjermania njoftoi se një vendosje iniciale e komandosëve do të hyjë në Kosovë të premten pasdite.



Presidenti amerikan i drejtohet kombit për të deklaruar fitoren kundër "Jugosllavisë"

# Clinton: "E kemi arritur një fitore për një botë më të sigurt"

- "Kemi bërë atë që duhet, e kemi bërë si duhet dhe do ta kryejmë punën", ka deklaruar Clintoni
- "Edhe kjo fazë do të jetë e rrezikshme. Kujtimet e hidhura edhe më tej do të jenë të freskëta dhe edhe më mund të ketë viktima", tha Clintoni. Mirëpo ai shtoi se forca paqeruajtëse "do të ketë mundësi dhe mandat për ta mbrojtur veten derisa e kryen punën e vet"

*ANNE GEAREN/AP*

WASHINGTON - Derisa trupat amerikane mësyjnë Kosovën, presidenti Clinton thotë se amerikanët duhet të mburren me fushatën e suksesshme ajrore kundër "RFJ"-së, por edhe se duhet të bëhen gati për pasojat eventuale, pasi që të fillojë puna e rrezikshme dhe e rëndë për mbajtjen e paqes.

"Kemi bërë atë që duhet, e kemi bërë si duhet dhe do ta kryejmë punën", ka deklaruar Clintoni.

79 ditë pas fjalimit të tij para kombit, në nismë të sulmeve të NATO-s kundër "Jugosllavisë", Clintoni ka shpallur fitoren në luftën e tij më të gjatë gjatë gjashtë vjetëve që i ka kaluar në pushtet.

"E kemi arritur një fitore për një botë më të sigurt, për vlerat tona demokratike dhe për një Amerikë të fortë", ka theksuar Clintoni të enjten mbrëma në një fjalim para kombit nga Dhoma ovale.

Mirëpo, me fytyrë të vërenjtur, Clintoni ka tërhequr vërejtjen se edhe më tutje ka rrezik për forcat paqembajtëse, midis të cilëve janë 7.000 ushtarë amerikanë.

"Edhe kjo fazë do të jetë e rrezikshme", ka theksuar Clintoni. "Kujtimet e hidhura edhe më tej do të jenë të freskëta dhe edhe më mund të ketë viktima". Mirëpo ai shtoi se forca paqeruajtëse "do të ketë mundësi dhe mandat për ta mbrojtur veten derisa e kryen punën e vet".

Clintoni njëherit sot e ka vizituar edhe bazën ajrore ushtarake Whitman në Misouri, prej nga pilotët e B-2-shëve nisen në aksion në Ballkan, në një rrugë që zgjatë 30 orë.

Forcat e Millosheviqit filluan të largohen nga Kosova të enjtën, ndërsa NATO-ja suspendoi fushatën e vet të bombardimeve. Nëse serbët veprojnë deri në fund sipas planit, NATO-ja do të ndalë fushatën e bombardimit edhe formalisht kah fundi i muajit.

Tani paqeruajtësit hyjnë në Kosovë, të sigurojnë rrugën për kthimin e refugjatëve shqiptarë në shtëpitë e tyre.

Në adresimin e tij 11 minutësh, të enjtën, Clintoni ua tërhoqi vërejtjen serbëve se Shtetet e Bashkuara nuk do t'i ndihmojnë ata që të rindërtojnë vendin e tyre pas bombardimeve "derisa vendi juaj është i udhëhequr nga një i akuzuar për krime lufte". Ai gati sa nuk bëri thirrje për kryengritje kundër Millosheviqit, duke u thënë serbëve se kanë vuajtur pa nevojë nën sulmet ajrore sepse ai (Millosheviqi) ka qenë i vendosur "që të eliminojë shqiptarët e Kosovës, të gjallë a të vdekur".

"Por, ne jemi të gatshëm të sigurojmë ndihmë humanitare dhe të ndihmojmë të ndërtohet një e ardhme më e mirë për Serbinë, gjithashtu, kur qeveria e saj të paraqesë tolerancën dhe lirinë, e jo represionin e terrorin", ka përfunduar Clintoni.



Disa nga reagimet lidhur me Marrëveshjen paqësore për Kosovën

## "Kemi besim në Zotin dhe NATO-n"

- Jovanoviq: "Republika Federale e `Jugosllavisë', nuk ka sulmuar asnjë nga fqinjët e saj dhe nuk i është kërcënuar askujt.
- Greenstock: "Ushtruesi i detyrës së përfaqësuesit `jugosllav' në KB tha: `Jugosllavia' nuk iu ka kërcënuar askujt. Është e qartë se 1.8 milion shqiptarë kosovarë, për autoritetet "jugosllave" bien shumë poshtë në kategorinë e `askujt'

KOMBET E BASHKUARA, 10 QERSHOR (REUTERS) - Më poshtë janë reagimet nga bota, lidhur me Marrëveshjen paqësore të së enjtes, për Kosovën dhe ndaljen e bombardimeve e NATO-s kundër "Jugosllavisë".

"Mund t'i raportoj popullit amerikan se kemi shënuar fitore për një botë me të sigurt, për vlerat tona demokratike dhe për një Amerikë më të fortë", tha presidenti i SHBA-së, Bill Clinton.

"Të gjithë duhet ta kenë të qartë se sa e madhe është sfida para së cilës gjendemi: pas dhunës, shkeljes së të drejtave të njeriut, dëbimit dhe shkatërrimit të vitit të kaluar. Obligimi i rivendosjes së një forme të jetës normale në Kosovë, është shumë i madh", deklaroi pas miratimit të rezolutës, sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan.

"Republika Federale e `Jugosllavisë', nuk ka sulmuar asnjë nga fqinjët e saj dhe nuk i është kërcënuar askujt. Solucionet, të cilat i imponohen Republikës Federale të `Jugosllavisë', paraqesin një shembull të rrezikshëm... inkurajim për grupet seperatiste dhe terroriste në tërë botën", tha Vladislav Jovanoviq, delegat "jugosllav", në OKB. Në këtë deklaratë reagoi ambasadori britanik në OKB, Sir Jeremi Greenstock i cili ndër të tjera tha: "Ushtruesi i detyrës së përfaqësuesit `jugosllav' në KB tha... `Jugosllavia' nuk iu ka kërcënuar askujt. Është e qartë se 1.8 milion shqiptarë kosovarë, për autoritetet "jugosllave" bie shumë poshtë në kategorinë e `askujt'. Tashti ne e kemi ndalur makinerinë e spastrimit etnik të Millosheviqit".

"Qëllimi ynë primar është krijimi i shkallës së sigurisë, brenda së cilës, të gjithë njerëzit mund të kenë një jetë normale. Ne do të merremi drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të ashpër me këdo që mundohet të na ndalojë që ta arrijmë këtë", tha gjenerali Sir Michael Jackson, komandant i NATO-s për Kosovën.

Kancelari gjerman, Gerhard Schroeder, tha se "dyert për paqe në Ballkan, janë hapur. Dhe ne do të bëjmë çdo gjë, që të sigurojmë se ato nuk do të mbyllen më kurrë".

"Dita e sotme është ditë historike. Morali dhe ligji kanë triumfuar mbi forcën brutale dhe barbarizmin", u shpreh presidenti francez, Jacques Chirac.

"Ndjej fuqishëm se është me rëndësi që të mundohemi ta avancojmë demokracinë në `Jugosllavi', por jo vetëm në `Jugosllavi', por edhe në Kroaci, gjithashtu", tha ndërmjetësi i BE-së për zgjidhjen e konfliktin në Kosovë dhe presidenti Finlandez, Martti Ahtisaari.

"Besojmë në Zotin dhe NATO-n. Do të shkonim që sonte, nëse është e mundur", Mihrie Kryeziu, refugjate nga Kosova, në Maqedoni.

"Mos harroni, disa nga ne shkojmë në shtëpi, për t'i varrosur të vdekurit", tha Muharrem Berisha, refugjat kosovar, në Maqedoni.

Në Këshillin e Sigurimit të OKB-së

## U miratua teksti i plotë i rezolutës për Kosovën

**Përmes kësaj rezolute autorizohet hyrja në Kosovë e një force paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO-ja, për të siguruar kthimin e sigurt të të zhvendosurve dhe të dëbuarve shqiptarë të Kosovës**

Teksti i rezolutës për Kosovën, i miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së të enjten është identik me atë të projektrezolutës, i cili është publikuar të enjten në gazetën "Koha ditore".

Përmes kësaj rezolute autorizohet hyrja në Kosovë e një force paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO-ja, për të siguruar kthimin e sigurt të të zhvendosurve dhe të dëbuarve shqiptarë të Kosovës. KS i OKB-së, po ashtu, ka autorizuar edhe vënien e një administrimi civil të OKB-së, për ta ndihmuar rindërtimin e Kosovës dhe për të promovuar një autonomi substanciale të Kosovës.

Teksti i projektrezolutës, i cili u miratua të enjten në KS të OKB-së, është hartuar në takimin e ministrave të Jashtëm të G-8-shes.

Teksti është miratuar me 14 vota për dhe me abstenimin e Kinës.



### Nga raporti ditor i Kosovapressit

# Fillon tërheqja e forcave serbe nga Rahoveci, Drenica dhe nga Dukagjini

**Sipas burimeve të agjencisë së lajmeve Kosovarpess nga Rahoveci, të enjten, rreth orës 14:00, policia serbe është larguar nga fshati Ratkoc, ku ka qenë e pozicionuar një kohë të gjatë, si edhe nga rajoni rreth maleve të Zatriçit**

TETOVË, 11 QERSHOR - Forcat serbe kanë filluar të enjten tërheqjen nga fshatrat Ratkoc e Zatriç të Rahovecit, kurse të premten ka pasur shenja të tërheqjes së tyre edhe në Drenicë e Dukagjin, pohon agjencia e lajmeve Kosovapress.

Sipas kësaj agjencie të lajmeve lëvizje të forcave policore ka pasur në rrethinën e Shtimjes.

Tërheqja e forcave serbe bëhet pas nënshkrimit të Marrëveshjes tekniko-ushtarake ndërmjet ushtarakëve të NATO-s dhe ushtarakëve serbë, me të cilën është paraparë programi i tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, pas 11 javësh të sulmeve ajrore të NATO-s.

Sipas kësaj marrëveshjeje ka afat deri më 21 qershor që ta braktisin Kosovën që të gjitha forcat serbe.

Sipas burimeve të agjencisë së lajmeve Kosovarpess nga Rahoveci, të enjten, rreth orës 14:00, policia serbe është larguar nga fshati Ratkoc, ku ka qenë e pozicionuar një kohë të gjatë. Edhe nga rajoni rreth maleve të Zatriçit është larguar një konvoj i ushtrisë serbe, pohon agjencia e lajmeve Kosovapress.

Kosovapressi, ndërkaq, raportoi të premten për shenjat e para të tërheqjes së forcave serbe nga territori i Drenicës.

Siç bën të ditur kjo agjenci lajmesh, tërheqja është vërejtur, para dite, kryesisht rreth fshatrave të Çyçavicës, si nga Dubofci, Beçiqi, Prellofci, Qirezi dhe Dobrosheci.

Sipas burimeve të kësaj agjencie lajmesh, gjatë tërheqjes nga Dobroshefci, kriminelët serbë kanë shtënë nga vendi i quajtur "Gospojë" në drejtim të popullatës civile dhe me atë rast kanë vrarë vajzën 13-vjeçare, Besmire Enver Hajdarin, nga ky fshat.

Kosovapressi pohon se të gjitha këto forca që po tërhiqen, tash për tash, janë duke u grumbulluar në Skënderaj.

Ndërkaq, nga pjesa veriperëndimore e Skënderajt nuk ka asnjë shenjë të tërheqjes së forcave serbe, raporton kjo agjenci e lajmeve. Përkundrazi, ato po granatojnë në drejtim të Llaushës, të Kotorrit, të Qubrelit dhe Vitakut.

Sektori për informim i Brigadës 113 të ZO të Drenicës raporton ndërkaq se ka filluar tërheqja e forcave serbe edhe nga Likoci, Rezalla dhe Morina.

Burimet e Kosovapressit nga ZO e Dukagjinti, njoftojnë se të premten në rajonin e Dukagjinit, janë shënuar vetëm tërheqje të pjesërishme të forcave serbe. Sipas këtyre burimeve forcat policore e ushtarake serbe janë tërhequr nga një punkt policor, në mes të Gllogjanit dhe Nepolës si edhe nga në punkt policor në Kosuriq dhe kanë shkuar në drejtim të Këpuzit.

Burimet e Kosovapressit bëjnë të ditur se forcat serbe edhe më tej kanë mbetur në Shaptej, Irzniq, Pozhar dhe në brezin kufitar me Shqipërinë.

Burimet e Kosovapressit pohojnë se forcat serbe kanë granatuar me dhjetëra granata 82-milimetërshe në drejtim të Ratishit dhe Dashinocit.

Forcat serbe, sipas burimeve të njëjta, vazhdojnë plaçkitjet dhe djegiet e fshatrave shqiptare, në Rekë të Keqe, Junik, dhe vise të tjera.

Në vendet nga ku janë laguar forcat serbe, është bërë minimi i terrenit. Minime të terrenit forcat kanë bërë edhe në Gërgoc, Kralan, Këpuz, Shaptej, Irzniq, pohon Kosovapressi.

Kosovapressi njëherësh bën të ditur edhe për lëvizje të forcave serbe në rrethinën e Shtimjes.

Kjo agjenci lajmesh duke u bazuar në raportet e vëzhguesve të Kompanisë I, II dhe III të Batalionit I të Brigadës 163 të ZO të Neredimes të UÇK-së, pohojnë se të enjten mbrëma forcat serbe kanë pasur këto lëvizje:" në orën 21:35, në drejtimin Shtime-Ferizaj kanë shkuar 4 automjete, në orën 21:55, një konvoj i përbërë prej 15 autobusësh dhe në orën 00:25, një konvoj prej 18 automjetesh. Në orën 04:17, në drejtimin Lipjan-Shtimje kanë shkuar 6 kamionë ushtarakë serbë, në orën 4:30, ka kaluar një kolonë e përbërë prej 3 xhipash, 4 veturash dhe 2 kamionësh.

Në orën 05:12, minuta, në rrugën Shtime-Ferizaj, kanë kaluar 2 pinzgauerë, 2 kamionë dhe 2 xhipa, në orën 06:25, në po të njëtën rrugë, kanë shkuar 6 tanke, në orën 07:15, kanë kaluar 5 kamionë. Në orën 08:05, në drejtimin Ferizaj-Shtimje, kanë shkuar një automjet praga dhe një pinzgauer ushtarak serb. Në orën 08:30, në drejtimin Ferizaj-Shtimje ka shkuar një autoblindë dhe një kamion, kurse në orën 08:25, kanë kaluar 2 kamionë transportues për bartjen e tankeve".

Kosovapressi ndërkaq bën të ditur se komanda e Brigadës 137 "Gjakova" e ZO të Dukagjinit ka demantuar lajmin se, më 10 qershor është kryer ndonjë sulm mbi ushtrinë serbe. Përkundrazi - thuhet në këtë demant-paramilitarët serbë kanë tentuar të hyjnë në zonën që kontrollon kjo Brigadë, por janë zmbrapsur.

Forcat serbe, siç pohon Kosovapressi, ende nuk kanë filluar tërheqjen nga ky rajon.

### Vazhdon tërheqja e forcave serbe nga Kosova

# Largohen njësitë "jugosllave" kundërajrore

**Afro 30 kamionë transportues ushtarakë, mëse 40 automjete me policë serbë apo me tabela regjistrimi të armatës jugosllave si dhe dy autobusë me njësitë speciale të policisë, largoheshin nga Kosova drejt Serbisë**

PODUJEVË, 11 QERSHOR/AFP - Njësitet kundërajrore serbe me mëse 100 automjete që bartnin lansues të raketave, raketa kundërajrore SAM 6 dhe SAM 20, si dhe radarë, janë parë duke lëvizur në veri të Kosovës, të premten.

Një reporter në terren tha se këto njësi ishin pjesë të konvojit ushtarak me mëse 400 automjete që ishin nisur në drejtim të Serbisë.

Më herët, një reporter tjetër i AFP-së ka parë afro 80 automjete që bartnin trupat serbe dhe policinë jashtë Kosovës, e që kalonin nëpër Merdarë.

Afro 30 kamionë transportues ushtarakë, mëse 40 automjete me policë serbë apo me tabela regjistrimi të armatës jugosllave si dhe dy autobusë me njësitë speciale të policisë, largoheshin nga Kosova drejt Serbisë.

Disa ushtarë dhe policë dukeshin të gëzuar dhe përshëndetnin kalimtarët. Të tjerët valvitnin flamurin "jugosllav" dhe serb apo edhe automatikët.

Merdari gjendet në vijën kufitare në mes të Kosovës e Serbisë, dhe në një autostradë dykahëshe që çon në drejtim të qytetit jugor të Nishit.

Rreth 12 kilometra nga Merdari, një konvoj tjetër ushtarak ishte nisur drejt kufirit kah ora 13:30.

Ky konvoj përfshinte katër automjete që mbanin topa kundërajrorë Praga 30 mm, shtatë topa të tjerë 40 mm, gjashtë radarë, një kamion transportues me kuti municioni dhe 21 kamionë të tjerë që mbanin pajisje të ndryshme teknike.

Në të njëjtën kohë, shumë familje serbe ikin nga Kosova përmes Merdares, dhe vetëm brenda 30 minutave, afro 40 automjete dhe dy traktorë, që bartnin familjet serbe dhe pajisjet e tyre shtëpiake janë parë të kenë kaluar kufirin.

Në anën tjetër të rrugës, transporterë të zbrazët të tankeve, kamionë, autobusë dhe kamionë-transportues të benzinës shkonin drejt kryeqytetit, Prishtinë.

Të premten në mëngjes, po në Prishtinë, që është 40 kilometra larg kufirit, mund të shiheshin lëvizje intensive të automjeteve ushtarake dhe të policisë.

Ishin këto shenja të evakuimit të shpejtuar të forcave serbe.

Të enjten, një konvoj me 108 automjete - që transportonin së paku 2.000 ushtarë serbë - është parë të ketë ikur nga Kosova përmes Merdares në orët e para të pasditës.

Tërheqja filloi disa orë para se NATO-ja të suspendojë fushatën e ajrore kundër "Jugosllavisë", pas 11 javëve.

Disa automobilë të civilëve, të stërmbushur me gjëra personale, ishin përzier me konvojin e automjeteve ushtarake, me familje serbe, që frikësohen nga hakmarrjet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo refugjatëve shqiptarë që mezi presin të kthehen.

### Deklaratë e Ministrisë së Mbrojtjes të Francës

# Trupat franceze futen në Kosovë; mobilizim i përgjithshëm i Ushtrisë franceze

**Zëdhënësi ka përmendur, ndër të tjera, se trupat e para franceze do të nisen nga Tuloni në rrugë detare në 48 orët që do të vijnë; kontigjentet e tjera do të nisen me rrugë ajrore javën që vjen. Ai ka theksuar se diskutimet që po vazhdojnë ende janë përqëndruar në konkretizimin e një Shtabi qëndror të përbashkët dhe për prezencën ushtarake ruse**

KOHA Ditore

*ILDA MARA*

PARIS - Në një deklaratë për shtyp të zëdhënësit të Ministrisë së Mbrojtjes, z. Jean-François Bureau, ka konfirmuar nisjen e 7.000 ushtarëve francezë. Ata do të kryejnë misione të ndryshme në fusha të specializuara si xhenierë ose për të siguruar mbrojtjen.

Zëdhënësi ka përmendur, ndër të tjera, se trupat e para franceze do të nisen nga Tuloni në rrugë detare në 48 orët që do të vijnë; kontigjentet e tjera do të nisen me rrugë ajrore javën që vjen. Ai ka theksuar se diskutimet që po vazhdojnë ende janë përqëndruar në konkretizimin e një Shtabi qëndror të përbashkët dhe për prezencën ushtarake ruse.

Pasi ka hedhur hipotezën se shumë brigada shumëkombëshe do të jenë nën kontrollin e vetëm të Shtabit të Përgjithshëm, zëdhënësi nuk ka përjashtuar faktin që edhe rusët të jenë nën këtë komandë.

Z. Jean-François Bureau ka treguar se gjenerali britanik, Michael Jackson, do të drejtojë komandën unike të operacioneve.

Është gjithashtu parashikuar pjesëmarrja e specialistëve të çështjeve civile-ushtarake, dhe prezenca e rezervistëve nuk është përjashtuar.

Kontigjenti i tanishëm që ndodhet në Maqedoni, mundet që nga ky moment të marrë pjesë në KFOR, pa pritur përforcime.

Objektivat qëndrore janë që të futen në Kosovë për të krijuar kushtet për riatdhesimin e refugjatëve. Z. Jean-François Bureau ka precizuar se radha e futjes në Kosovë nuk është konkurs me anëtarët e tjerë të KFOR-it në mesin e NATO-s.

Ai konfirmoi se elementet e para të një batalioni prej 1200 ushtarësh të Ushtrisë së Tokës që do të fillojnë sot përgatitjen ushtarake në Francë, në kuadrin e një akordi të partneritetit strategjik. Kjo stërvitje do të zhvillohet në Briancon dhe në Barcelonette e me pas në Canjuers. Nuk përjashtohet fakti që këto forca speciale të marrin pjesë në forcën e paqes në Kosovë.



Deklaratë e Carl Bildit-dhënë BBC-së

# “Serbët do të mund të digjnin çdo gjë para ikjes së tyre nga Kosova”

**“Kam frikën se do të kemi një valë të re refugjatësh, më shumë se 100.000 dhe gjithashtu kam frikën se do të kemi një valë shkatërrimesh, vjedhjesh dhe djegie të çdo gjëje, gjatë largimit nga ajo që ata e konsiderojnë të jetë, atdheu i tyre”, i tha Bildt televizionit të BBC-së**

LONDËR, 11 QERSHOR/REUTERS - I dërguari special i OKB-së, Carl Bildt, tha të enjten se frikësohet se 100.000 serbët, të cilët jetojnë në Kosovë, mund të largohen nga Kosova dhe të lënë prapa shkatërrime, derisa një milion shqiptarë të zhvendosur të kthehen.

Bildt theksoi se rikonstruktimi i Kosovës, ishte projekti më i madh rindërtues, që Perëndimi ka parë, që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, duke shtuar se presidenti “jugosllav”, Slobodan Millosheviq, duhet të zëvendësohet, në të mirë të rajonit ballkanik.

“Kam frikën se do të kemi një valë të re refugjatësh, më shumë se 100.000 dhe gjithashtu kam frikën se do të kemi një valë shkatërrimesh, vjedhjesh dhe djegie të çdo gjëje, gjatë largimit nga ajo që ata e konsiderojnë të jetë, atdheu i tyre”, i tha Bildt televizionit të BBC-së.

“Shpresoj se ndryshimet politike në Beograd do të vijnë shumë, shumë shpejt, sepse ajo do të ishte shumë mirë për rajonin”, shtoi ai.

NATO-ja e ndali fushatën 11-javëshe bombarduese të saj, kundër “Jugosllavisë”, të enjten dhe tha se trupat e saj paqeruajtëse do të shkojnë në Kosovë, të shtunën.



Qartësohen dyshimet se për Millosheviqin nuk do të ketë ndihma

# Dini: Nuk do të ketë ndihmë për rikonstruktim për Millosheviqin

**“Duhet të presim që forcat demokratike në Serbi të kërkojnë dhe të promovojnë ndryshime. Prej atij çasti, Serbia do të fillojë intergrimin e vet në Evropë dhe me pjesën tjetër të rajonit të Ballkanit”, shtoi ai**

ROMË, 11 QERSHOR (REUTERS) - Ministri italian i Punëve të Jashtme, Lamberto Dini, deklaroi në një intervistë të botur të premten se “Jugosllavia” nuk do të pranojë kurrfarë ndihme për rikonstruktim derisa një udhëheqës demokratik të mos zëvendësojë presidentin Slobodan Millosheviq.

Dini, i cili insistoi gjatë konfliktit në Kosovë se dialogu duhet të mbahet i hapur gjatë gjithë kohës me Beogradin, tha se sidoqoftë ishte e drejtë që popullit të zakonshëm të Serbisë t'i ofrohej ndihmë humanitare.

“Problemi është nëse rindërtimi i urave është ndihmë që do të shfrytëzohej nga Millosheviqi apo ndihmë humanitare. Do të thosha se duhet të jemi kundër asaj ndihme”, i deklaroi Dini gazetës ditore të Milanos “Corriere della Sera”.

“Duhet të presim që forcat demokratike në Serbi të kërkojnë dhe të promovojnë ndryshime. Prej atij çasti, Serbia do të fillojë intergrimin e vet në Evropë dhe me pjesën tjetër të rajonit të Ballkanit”, shtoi ai.

Sa i përket ndihmës së përgjithshme kushtuar “Jugosllavisë” për rikonstruktim, Dini deklaroi: “Nuk besoj se do të ketë konsensus për këtë derisa Millosheviqi të mbetet në pushtet”.



Sipas zyrtarëve amerikanë

# KB-ja përballet me një detyrë “gjigante” në Kosovë

**“Askush le të mos dyshojë në rëndësinë e sfidave tona: pas dhunës, shkeljes së drejtave të njeriut, largimin dhe shkatërrimin gjatë vitit të kaluar, detyra për rikthimin e Kosovës në jetën normale është tepër e rëndësishme”, tha në këshill, sekretari i përgjithshëm i KB-së, Kofi Annan**

KOMBET E BASHKUARA, 11 QERSHOR/REUTERS - Derisa ngjyra është ende duke u tharë në dokumentin e nënshkruar për Planin e paqes për Kosovën, Kombet e Bashkuara janë duke u përballur me një detyrë të rëndë për të ndihmuar qinda-mijëra refugjatëve që do të kthehen në shtëpitë e tyre dhe do të rindërtojnë jetët e tyre.

Këshilli i Sigurimit, në një rezolutë të enjten, ka autorizuar organizatat botërore që të caktojnë përfaqësuesit specialë që do të udhëheqin operacionet civile. Këtu përfshihen disa mijëra punëtorë humanitarë, zyrtarë dhe policë që të rivendosin refugjatët dhe të vendosin “një administratë të përkohshme në Kosovë”.

“Askush le të mos dyshojë në rëndësinë e sfidave tona: pas dhunës, shkeljes së drejtave të njeriut, largimin dhe shkatërrimin gjatë vitit të kaluar, detyra për rikthimin e Kosovës në jetën normale është tepër e rëndësishme”, tha në këshill, sekretari i përgjithshëm i KB-së, Kofi Annan.

NATO-ja që ka suspenduar fushatën e saj të bombardimeve dhe ka grumbulluar 17.500 trupa përgjatë kufirit të Kosovës që janë të gatshëm për Misionin ndërkombëtar paqeruajtës që e miratoi këshilli.

Rezoluta e këshillit, që përmban komponentet ushtarake dhe civile të Planit paqësor të Kosovës, u miratua me 14 vota për dhe asnjë kundër, ndërsa Kina abstenoi.

Kjo i dha vulë legjimitetit të KB-së lidhur me operacionet e NATO-s në Kosovë. Kjo ishte në kundërshtim me fushatën e bombardimeve ngaqë NATO-ja veproi pa kërkuar autorizim nga këshilli, duke ditur se do të mund të ndalohej nga vetot e Rusisë dhe Kinës.

Zyrtarët e KB-së thonë se Annani do të vendosë se kush do të jetë përfaqësues special për Kosovën së shpejti. Ndër kandidatë që janë përmendur ka qenë Dick Spring, ish-ministri i Jashtëm irlandez dhe Lakhard Ibrahimi, ish-ministri i Jashtëm algjerian që ka udhëhequr Misionin e KB-së në Haiti dhe Afganistan ndër të tjera.

Me kontigjentin ushtarak që tashti udhëheqet nga evropianët - gjeneral-leitnanti, Micahael Jackson, - SHBA-të kanë dëshiruar të komandojë një amerikan.

Por diplomatët thonë se Annani me siguri do ta caktojë dikë prej vendeve që nuk janë në NATO.

Kjo do të përjashtonte amerikanin Jacque Klein, i cili ka udhëhequr operacionin ushtarak dhe civil në Kroaci në rajonin e Sllavonisë Lindore dhe tashti është në Bosnjë në postin e zëvendëspërfaqësuesit të lartë.

Një kandidat tjetër me përvojë në Ballkan, ish-kryeministri suedez Carl Bildt, përfaqësuesi i parë i lartë në Ballkan, u tërhoq nga kandidimi në fillim të kësaj jave.

Vota e të enjtes e këshillit u përcoll me ngjarje të rëndësishme që filluan me nënshkrimin e Marrëveshjes ushtarake të mërkurën nga NATO-ja dhe gjeneralët “jugosllavë” që i bënte thirrje Serbisë t'i tërheqë forcat nga Kosova brenda 11 ditësh.

Pasi që të verifikohet tërheqja e trupave serbe, NATO-ja ka theksuar të enjten se do të ndalë fushatën e saj bombarduese 11-javëshe.

Rezoluta gjithashtu kërkon bashkëpunim me Tribunalin për Krime Lufte, në Hagë, që në maj ka akuzuar presidentin Slobodan Millosheviq dhe katër bashkëpunëtorë të tij për ofensivat kundër shqiptarëve të Kosovës, 850.000 prej të cilëve janë larguar nga vendi.

Qeveria gjermane merr vendim për shtimin e kontigjentit ushtarak të trupave Bunderswehrit gjerman

# Në Kosovë do të ketë 8.500 ushtarakë gjermanë

**Kabineti gjerman mori vendim për shtimin e kontigjentit ushtarak gjerman nga 6.000 në 8.500 trupa, të cilat do të vendosen në juglindje të Kosovës në kufi me Maqedoninë, me qendër-Prizrenin**

*BEQË CUFAJ*

BONN, 11 QERSHOR - Qeveria gjermane, sot, është mbledhur me një ditë vonesë për të shqyrtuar vendimin për shtimin e kontigjentit të trupave të Bundeswehrit i cili do të marrë pjesë në kontigjentin e trupës ndërkombëtare të Kosovës KFOR.

Shtimi nga dje për sot, në Bonn, është arsyetuar me faktin se Qeveria gjermane ka pritur vendimin për miratim e rezolutës së KS të OKB-së, gjë kjo e cila edhe ndodhi mbrëmë.

Në këtë kontekst kabineti gjerman edhe mori vendimin sot për shtimin e kontigjentit ushtarak gjerman nga 6.000 në 8.500 trupa të cilat do të vendosen në juglindjen e Kosovës dhe kjo në kufi me Maqedoninë, me qendër-Prizrenin.

Qeveria gjermane po kështu ka ndryshuar tekstin e vendimit për përfshirjen e këtyre trupave, duke ia përshtatur atë tekstit të rezolutës së miratuar mbrëmë nga KS i OKB-së.

Pritet që këtë vendim të Qeverisë gjermane me shumicë absulute sot do ta marrë edhe Bundestagu gjerman.



### Ministria e Punëve të Jashtme të Francës: Nisin përgatitjet për Samitin vjetor të shefave të shteteve më të industrializuara:

# Kosova dhe Ballkani - preokupim kryesor

**Temat qendrore në urdhrin e ditës do të jenë: çështjet e sigurimit dhe çështjet e marrjes së masave dhe të zgjidhjes së konfliktetve. Konferenca e ministrave për Paktin e stabilitetit do të mbyllë këtë sesion**

KOHA Ditore *ILDA MARA*

PARIS - Zëdhënësja e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, zonja Anne Gazeau-Secret, ka bërë një paraqitje në një konferencë shtypi të enjten, për mbledhjen e ministrave të punëve të jashtme që mbahej në Koln, më 9 dhe më 10 qershor.

Kjo mbledhje, tha ajo, bën pjesë në përgatitjen e takimit të shefave të shteteve të industrializuara, që do të zhvillohet, më 18 dhe më 20 qeshor. Ministrat do të përqendrohen mbi situatat rajonale. Tema e Kosovës dhe e Ballkanit do të jetë sërish në qendër të vëmendjes.

Temat qendrore në urdhrin e ditës do të jenë: çështjet e sigurimit dhe çështjet e marrjes së masave dhe të zgjidhjes së konflikteve. Konferenca e ministrave për Paktin e stabilitetit do të mbyllë këtë sesion.

Përsa i përket Kosovës, mbledhja e G-8-shes, më 7 dhe më 8 qershor ka bërë të mundur vënien në jetë të rezolutës e cila mundësoi daljen nga kriza.

Franca ka luajtur një rol shumë aktiv në përpunimin e këtij teksti i cili arriti në një sukses të madh. Gjithashtu zedhënësja e Ministrisë së Jashtme ka përgëzuar rolin qendror që ka luajtur Këshilli i Sigurimit të OKB-së në këtë proces paqeje.

Projekti i rezolutës është konform objektivave të Francës:

- të bashkëpunojmë me Rusinë për të arritur një zgjidhje të krizës,
- të garantojë dhe të mbështesë parimet e G-8-shes, të NATO-s dhe akordin "Ahtisaari - Chernomirdin": tërheqje të forcave serbe; zbarkim i forcës së sigurimit; komandim dhe kontroll i bashkuar; afirmim i autoritetit të Këshillit të Sigurimit; sinkronizim i zbarkimit të forcave të KFOR-it me tërheqjen e trupave serbe, derisa të evitohen zonat gjeografike që nuk do të jenë nën sigurimin e forcës së paqes.

Zëdhënësja e ministrisë theksoi se duhet të ketë një bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe të ngushtë midis KFOR-it dhe T.P.I. (Gjyqit Penal Ndërkombëtar).

### Sipas kryetarit të ri të Komisionit Evropian

# Vendeve të Balkanit t'u ofrohet anëtarësimi në BE, thotë Prodi

**"Qëllim yni është që të heqim barrierat doganore në rajon", ka thënë Prodi, duke shtuar se "në këtë mënyrë do të krijoheshin zona aktive ekonomike ekstensive"**

BONN, 11 QERSHOR/AFP - Kryetari i ri i Komisioit Evropian, Romano Prodi, ka deklaruar se vendeve të Ballkanit, të goditura në mënyrë direkte nga kriza në Kosovë, do të duhej t'u ofrohej anëtarësimi në Bashkësinë Evropiane.

"Çdo vend që ka pësuar do të duhej të përfshihej në Programin e rindërtimit: Shqipëria, Maqedonia, Jugosllavia dhe Kroacia", është shrpehur ish-kryeministri italian, në një intervistë dhënë të së përditshmes gjermane Bild.

"Mbi të gjitha, vendeve të Ballkanit do të duhej t'u ofrohej prospekti i anëtarisë në BE", citohet të ketë thënë ai.

Prodi shoshiti çështjen se BE-ja duhet të inkuadrohet në rindërtimin ekonomik dhe atë politik të Ballkanit, duke shtuar, ndërkaq, se mjetet për të bërë këtë tashmë i kanë në dorë.

"Qëllim yni është që të heqim barrierat doganore në rajon", ka thënë Prodi, duke shtuar se "në këtë mënyrë do të krijoheshin zona aktive ekonomike ekstensive".

I pyetur se a do të ndihmohej rindërtimi i Jugosllavisë me kryetarin Millosheviq në krye, Prodi u përgjigj shkurt: "BE-ja nuk mund t'i sigurojë fonde një vendi jodemokratik".

### Konferencë shtypi e OH "El Hilal"

# Shehapi: "Të dëbuarit duan të kthehen në vendin e tyre"

**"Bazuar në anketën e kryer para disa ditësh nga OH "El Hilal" si edhe organizata humanitare ARC nga SHBA-ja lidhur me disponimin e tyre për kthim në vatra të tyre, u konstatua se ata janë jetësisht të interesuar që të kthehen në Kosovë, në qoftë se implementimi i marrëveshjes bëhet në mënyrë të sigurt", deklaroi Shehapi**

KOHA Ditore *BESNIK KAJTAZI*

TETOVË, 11 QERSHOR - Në konferencën e djeshme të shtypit, sekretari i përgjithshëm i OH "El Hilal", Behixhudin Shehapi, shprehu vlerësimin pozitiv për Marrëveshjen ushtarako-teknike të arritur për kthimin në shtëpitë e tyre të të gjithë të dëbuarve nga Kosova.

"Bazuar në anketën e kryer para disa ditëshe nga OH "El Hilal" si edhe organizata humanitare ARC nga SHBA-ja lidhur me disponimin e tyre për kthim në vatra të tyre, u konstatua se ata janë jetësisht të interesuar që të kthehen në Kosovë, në qoftë se implementimi i marrëveshjes bëhet në mënyrë të sigurt", deklaroi Shehapi dhe shtoi se "shumë të dëbuar me dhunë janë optimistë dhe mezi presin që të kthehen në vendin e tyre".

"Ky njëherësh është qëndrim zyrtar edhe i 'El Hilalit' mgjithqë disa të anketuar kishin shprehur rezerva lishur me Marrëveshjen paqësore", tha Shehapi.

Në vazhdim të konferencës së shtypit Shehapi vazhdoi duke thënë se roli dominant i OH "El Hilal" u dëshmua edhe në projektet që po përgatiten nga organizatat humanitare ndërkombëtare, siç është ai me riatdhesimin e kosovarëve në shtëpitë e tyre. "El Hilal" do të ndërlidhet me programet e dy apo tri organizatave më relevante të Kombeve të Bashkuara si: UNHCR, UNICEF, të cilat do të zhvillohen në disa faza.

Organizata humanitare është në bashkëpunim me UNICEF-in në një projekt që ka të bëjë me edukimin dhe përgatitjen e nënave dhe të fëmijëve kosovarë për kthim në Kosovë dhe për t'i përballur terrenet e minuara. Kjo do të realizohet nëpërmjet edukatës vizuale dhe ligjëratave ku do të përdoren edhe ilustrime të ndryshme. Për këtë "El Hilal" do të japë kontributin e vet në aspektin humanitar, do të bashkëpunojë edhe me organizatën IMC, ku aktivistët e "El Hilalit" do t'i nënshktrohen trajnimit për edukatë shëndetësore në kushte te reja.

"OH 'El Hilal' është angazhuar për strehimin e të dëbuarve në shtëpi private dhe sjelljen e ndihmanve nga jashtë, të cilat janë të nevojshme duke pasur parasysh atë se familjet që i kanë strehuar ata kanë probleme të ndryshme", tha Behixhudin Shehapi, sekretar i përgjithshëm i OH "El Hilali".

Sipas sekretarit të përgjithshëm nga organizatat ndërkombëtare prej fillimit të qershorit kanë arritur 29 kamionë më ndihma ushqimore, veshmbathje dhe mjete higjienike.

"Si rezultat i projekteve të realizuara lidhur me këtë katastrofë humanitare, gjatë kësaj periudhe arriti edhe një kontigjent ndihmë prej 3 tonësh qumësht pluhur prej 'Bankës Islamike për Zhvillim' me seli në Xheda".

Organizata humanitare "El Hilal" i ka ndihmuar edhe gazetës së përditshme "Koha ditore" rreth tërheqjës së donacioneve nga Ministria e Punëve të Jashtme e Francës.

Sekretari i përgjithshëm i OH "El Hilal" hudhi poshtë spekulimet se kjo organizatë po u ndihmonte të të dëbuarve nga Kosova që të trasferoheshin në vende të treta, duke thënë se "kjo nuk ka të bëjë fare me të vërtetën. E vërteta është se ne iu kemi përmbajtur përcaktimeve tona, që duke u bazuar në strategjinë e ndërtuar që nga fillimi i kësaj katastrofe humanitare, të dëbuarit të mbahen sa më afër Kosovës, për ç'gjë dëshmon edhe strehimi masiv i të të dëbuarve në shtëpi private".

Shehapi në vazhdim vetëm sqaroi se "El Hilal", Dega në Tetovë, bashkëpunon vetëm me përfaqësues të një organizate humanitare holandeze për gjetjen e të sëmurëve kronikë në gjendje të vështirë shëndetësore, të cilët në përcjellje të anëtarëve të familjeve të veta janë dërguar në Holandë.

"Jashtë këtij rasti nuk është evidencuar asnjë aksion tjetër i ngjashëm i OH 'El Hilal' që në çfarëdo mënyre ka të bëjë me transferimin e të të dëbuarve në vende të treta", tha në fund të konferencës së shtypit sekretari i përgjithshëm i OH "El Hilal", Behixhudin Shehapi.

EL HILAL

### Prej orës 11:00

# Protesta në kampin në Radushë kundër hapave ruse rreth Kosovës

RADUSHË - Sot, më 11 qershor, në orën 11:00, do të mbahen protesta të shqiptarëve të Kosovës të vendosur në kampin e refugjatëve në Radushë.

Protestat, thonë organizatorët në kamp, organizohen për të protestuar kundër tendencave të rusëve që të marrin nën kontroll të tyrin, jashtë komandës së NATO-s, një pjesë të territorit të Kosovës.

Rusët, thonë shqiptarët në kampin në Radushë, janë vënë qartë në anën e njërës palë në konflikt - serbëve, dhe kanë marrë pjesë në mënyrë direkte në krimet e kryera kundër shqiptarëve në Kosovë.

Prandaj, shtojnë refugjatët, ata kanë humbur të drejtën të konsiderohen si paqeruajtës nga kosovarët.

Në të vërtetë, ata shikohen me të njëjtin sy sikur serbët, dhe konsiderohen si okupatorë.

Nëse ata marrin një pjesë të Kosovës, kjo do të thotë se atë e ka marrë Serbia, dhe e ka ndarë Kosovën, përfundojnë kosovarët e dëbuar në kampin e Radushës.



### Sipas Komisionit Evropian

# BE: "S'ka ndihma për Jugosllavinë, nëse Milosheviqi është në fuqi"

**Zyra e ndihmave humanitare e BE-së (ECHO) tanimë ka dhënë 50 milionë euro (52.4 milionë dollarë) për të ndihmuar kthimin e gati një milion kosovarëve**

BRUKSEL, 11 QERSHOR/AFP - Bashkësia Evropiane ka deklaruar se nuk do të financojë rindërtimin e Jugosllavisë së dëmtuar rëndë derisa Slobodan Milosheviqi të jetë në pushtet, i ka deklaruar agjencisë AFP zëdhënësi i Komisionit Evropian.

"Ne ende refuzojmë t'i japim Beogradit ndihmë financiare. Nuk do ta ndihmojmë Slobodan Milosheviqin", ka thënë zëdhënësi,.

Ai nuk konfirmoi se një takim i kontribuesve potencialë do të mbahet së shpejti dhe se fondet do të ndihmojnë rikthimin e refugjatëve kosovarë.

"BE-ja është gati të marrë mbi vete përgjegjësinë financiare për të rindërtuar Kosovën dhe vendet përreth, me ndihmën e vendeve tjera", tha ai.

Zyra e ndihmave humanitare e BE-së (ECHO) tanimë ka dhënë 50 milionë euro (52.4 milionë dollarë) për të ndihmuar kthimin e gati një milion kosovarëve.

Fondet do të mbulojnë shpenzimet e dy tre muajve të ardhshëm dhe do të jepen për rindërtimin e shtëpive të refugjatëve si dhe për plotësimin e nevojave themelore shtëpiake, siç janë veshmbathja, krevatët, mbulojat, enët,...

SHBA-ja ka thënë se BE-ja vetëm duhet të financojë rindërtimin e Jugosllavisë, pasiqë SHBA-ja ka bartur barrën kryesore financiare të sulmeve ajrore të NATO-s.

### Kanadaja dërgon një ekip ekspertësh të mjekësisë ligjore në Kosovë

# Kanadaja: E vërteta do të mësohet gjithsesi

**I pyetur nëse Ushtria "jugosllave" kishte shkatërruar tepër dëshmi, ministri kanadez i Punëve të Jashtme Axworthy tha: "Mendoj se ka pasur tepër shumë që ata t'i shkatërronin"**

OTAVË/AFP - Një ekip prej tetë ekspertësh kanadezë të mjekësisë ligjore do të kalojë një muaj në Kosovë, duke mbledhur dëshmi të cilat do t'i shfrytëzojnë prokurorët e Tribunalit për Krime Lufte në gjykimet e ardhshme kundër zyrtarëve "jugosllavë" të ngarkuar me krime lufte, deklaroi të mërkurën ministri i Punëve të Jashtme Lloyd Axtworthy.

Duke folur para gazetarëve kanadezë në Cöln, ku ai mori pjesë në takimin e ministrave të jashtëm të grupit të tetëve, Axworthy tha se hetuesit nga policia speciale mbretërore kanadeze do të përfshijë patologë dhe fotografë.

Ekipi do të kalojë një muaj në Kosovë, duke vizituar vendet ku janë raportuar varrezat masive, duke grumbulluar dëshmi.

Axworthy deklaroi se hetuesit pastaj do të kalojnë rreth të muaj në Kanada duke u marrë me dëshmitë para se t'ia dorëzojnë Tribunalit...

I pyetur nëse Ushtria "jugosllave" kishte shkatërruar tepër dëshmi, Axworthy tha: "Mendoj se ka pasur tepër shumë që ata t'i shkatërrojnë". Më vonë, zëdhënësi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Jim Wright, u deklaroi gazetarëve se "dhjeta-mijëra kosovarë janë zhdukur, shumica e tyre frikësohet se janë të vrarë". Ai konfirmoi se kishte dyshime se Ushtria "jugosllave" kishte tentuar të shkatërronte dëshmitë. "Ne e dimë se shumë trupa të viktimave janë krematuar", tha ai. Por tashmë ka dëshmi të mjaftueshme për të filluar hetime të detajuara pas dëshmive nga refugjatët në Maqedoni dhe në Shqipëri të cilët ua kanë treguar hetuesve rreth ekzekutimeve të shpejta, shkatërrimi i dokumentave të identitetit dhe pronës. "Në një mënyrë apo në tjetrën", premtoi Wright, "e vërteta do të mësohet".

### Pas arritjes së marrëveshjes për dhënien fund të krizës në Kosovë

# Hungaria bën presion për autonomi për hungarezët e Vojvodinës

**"Ne është dashur t'ia bëjmë të qartë Serbisë se dëmtimi i çdo hungarezi në Serbi do të rezultojë me pasoja shumë serioze, të paparashikueshme dhe të patolerueshme", tha Orban**

BUDAPEST, 11 QERSHOR/ REUTERS - Hungaria dhe hungarezët etnikë të Serbisë bënë presion të premten për autonomi më të madhe për provincën veriore të Serbisë ku jeton pjesa më e madhe e minoritetit hungarez. Jozsef Kasza, president i Shoqatës së hungarezëve të Vojvodinës, gjithashtu tha në konferencën për shtyp në Budapest se komuniteti i hungarezëve etnikë prej 350.000 në Serbi dëshironte një rol në çfarëdo qeverie të ardhshme "jugosllave".

"Mund të paramendoj se Shoqata e hungarezëve të Vojvodinës do të marrë një rol në qeverinë e re jugosllave", deklaroi Kasza në paraqitjen e përbashkët me ministrin hungarez të Punëve të Jashtme, Janos Martonyi.

Kasza dhe Martonyi, në deklaratat e transmetuara nga agjencia hungareze e lajmeve MTI, përkrahën autonominë për provincën veriore serbe ku jeton shumica e hungarezëve etnikë të Serbisë.

MTI-ja tha se ishte pajtuar që plani për autonomi të Vojvodinës të përfshihet si pjesë e çfarëdo përpjekjeje të përgjithshme për të demokratizuar "Jugosllavinë" pas përfundimit të fushatës ajrore të NATO-s.

"Ne besojmë se pjesëmarrja e përfaqësuesve politikë të hungarezëve të Vojvodinës do të ishte e domosdoshme për procesin e demokratizimit të Jugosllavisë", deklaroi Martonyi.

"Kjo do të mund të bënte procesin edhe më të besueshëm për tërë botën".

Autonomia të cilën e gëzonte Vojvodina nën pushtetin e diktatorit të fundit të Jugosllavisë, mareshali Tito, ishte revokuar së bashku me atë të Kosovës pas vdekjes së Titos.

Më herët, kryeministri hungarez, Viktor Orban, deklaroi se suksesi i NATO-s në konfliktin e "jugosllavisë" ishte lajm i mirë për komunitetin etnik hungarez në Serbinë Veriore.

Rezultati tregoi se represioni ndaj minoriteteve kombëtare nuk do të tolerohej, tha ai në një transmetim televiziv të enjten në mbrëmje.

"Ky është një sukses i madh esencial për hungarezët, ngase me këtë, i është bërë e qartë Serbisë, dhe çdo vendi tjetër, jo vetëm që hapa të tillë nuk mund të merren kundër shqiptarëve, por që këto metoda nuk mund të përdoren kundër asnjë minoriteti kombëtar", tha Orban.

Hungaria është e vetmja anëtare e NATO-s që kufizohet me "Jugosllavinë".

"Ne është dashur t'ia bëjmë të qartë Serbisë se dëmtimi i çdo hungarezi në Serbi do të rezultojë me pasoja shumë serioze, të paparashikueshme, dhe të patolerueshme", tha Orban. Ne kemi pasur sukses në këtë. Nuk ka pasur mizori kundër komunitetit hungarez të Vojvodinës.

### Ndër detyrat e para të KFOR-it

# Heqja e minave ndër detyrat më të vështira

**Heqja e minave, para kthimit të gati një milion refugjatëve në shtëpitë e tyre, do të jetë një proces i gjatë dhe i rrezikshëm**



PARIS, 11 QERSHOR/AFP - Një nga detyrat e para të KFOR-it do të jetë t'i detektojë dhe pastrojë mijëra mina të vëna nga armata jugosllave në vitin e fundit.

Autoritetet jugosllave, në përputhje me marrëveshjen ushtarake të kësaj jave, do të duhej t'i dorëzonin të gjitha informatat rreth minava dhe mjeteve tjera shpërthyese të vëna nga ta.

Sidoqoftë, heqja e minave, para kthimit të gati një milion refugjatëve në shtëpitë e tyre, do të jetë një proces i gjatë dhe i rrezikshëm.

Ekspertët e çmontimit të minave përdorin disa teknika në punën e tyre, e ndër to:

Automjete të blinduara. Këto lëvrojnë tokën në të cilën janë vënë minat. Mund të përdoren vetëm në terren të përshtatshëm, dhe nuk i zbulojnë rreth 20 për qind të minave.

Qenët e stërvitur. Këta janë në gjendje t'i ndiejnë aromat e minave. Kërkojnë stërvitje kohëgjata dhe lodhen shumë shpejt.

Detektorët metalikë. Këta bëjnë punë mirë kur është fjala për minat e mbështjella me metale. Por, në shumicën e minave bashkëkohore, metalet janë zëvendësuar me plastikë.

Minat plastike nuk mund të detektohen, dhe specialistët e deminimit duhet të shpojnë tokën çdo pesë centimetra me ndonjë mjet të metaltë, të cilin e fusin në tokë në kënd prej 45 shkallësh, për të mos e prekur detonatorin. Kur ato të locohen, minat e plastikës ose neutralizohen dhe lihen të ndryshken vetvetiu, largohen që të shkatërrohen në ndonjë vend tjetër, ose detonohen aty në vend.

### Pas miratimit të rezolutës për Kosovën nga Këshilli i Sigurimit

# Argjentina ofron 500 trupa për forcën e NATO-s në Kosovë

**Ministri argjentinas i Mbrojtjes, Jorge Dominguez, tha se vendi i tij do të dërgojë një kompani ushtarake të motorizuar, një skuadron helikopterësh UH-1H, një kompani të korpusit të marinës, një njësi spitalore mobile dhe forca të tjera të sigurisë për të ndihmuar në kontrollimin e kufirit**

WASHINGTON, 10 QERSHOR/ REUTERS - Argjentina të enjten premtoi një kontigjent prej 500 trupash që t'i bashkohen forcës paqeruajtëse të drejtuar nga NATO-ja që do të fillojë të hyjë në Kosovë të shtunën. Ministri argjentinas i Mbrojtjes, Jorge Dominguez, tha se vendi i tij do të dërgojë një kompani ushtarake të motorizuar, një skuadron helikopterësh UH-1H, një kompani të korpusit të marinës, një njësi spitalore mobile dhe forca të tjera të sigurisë për të ndihmuar në kontrollimin e kufirit.

Dominguez këtë e bëri të njohur në Pentagon disa orë pasi Këshilli i Sigurimit i OKB-së i dha dritën e gjelbër forcës së drejtuar nga NATO-ja për të hyrë në Kosovë dhe për t'i kthyer një milion refugjatë shqiptarë në shtëpitë e tyre. "Ky është një lajm shumë i mirëseardhur, që vjen pas rezolutës së OKB-së", deklaroi sekretari amerikan i Mbrojtjes, William Cohen, për ofertën e Argjentinës. Cohen përshëndeti përfshirjen e Argjentinës në Misionin botëror paqeruajtës në Haiti, Bosnjë, Qipro dhe në Saharën Perëndimore. Nën drejtimin e presidentit Carlos Menem, Argjentina ka rreshtuar veten me vendosmëri në vijë me Shtete të Bashkuara, duke filluar me pjesëmarrjen e tyre në dy anije luftarake gjatë luftës në Gjirin Persik, më 1991, të cilat kishin rol joluftarak.



Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) paralajmëron vazhdimin e bashkëpunimit me vende të Ballkanit

# FMN: Banka Botërore të marrë rolin udhëheqës

**"Banka Botërore do të marrë rolin udhëheqës, ne (FMN-ja) do të jemi atje për të siguruar se makrostabiliteti do të mbahet", i deklaroi Reutersit, Fischer në një intervistë televizive**

FRANKFURT, 11 QERSHOR/ REUTERS - Zëvendësi i parë i drejtorit të menaxhmentit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Stanley Fischer, tha të premten se FMN-ja do të pwrfshihet në rikonstruktimin e Ballkanit, por Banka Botërore duhej të ishte ajo që do të udhëheqte.

"Banka Botërore do të marrë rolin udhëheqës, ne do të jemi atje për të siguruar se makrostabiliteti do të mbahet", i deklaroi Reutersit, Fischer në një intervistë televizive.

Fischer deklaroi se FMN-ja panifikon të vazhdojë t'u ndihmojë vendeve të rajonit, të cilat ishin anëtare të FMN-së dhe me të cilat ka punuar në të kaluarën.

"Jugosllavia nuk është anëtare e FMN-së, por ne planifikojmë t'i ndihmojmë vendeve të tjera", tha ai.

Sipas Televizionit shtetëror maqedonas

# Dy shtetas maqedonas janë vrarë në Kosovë

**Ata ishin sulmuar afër qytezës Kaçanik, pasi që kishin kaluar vendkalimin kufitar në Bllacë, ku mijëra refugjatë shqiptarë janë të strehuar në kamp, e kishte cituar televizioni, Ministrinë e Brendshme**

SHKUP, 10 QERSHOR (REUTERS) - Dy maqedonas ishin vrarë, kur vetura e tyre u qëllua nga një raketahedhës dore, pak kohë pasi që ata kishin kaluar në pjesën jugore të Kosovës, të enjten në mëngjes, raportoi Televizioni shtetëror maqedonas.

Ata ishin sulmuar afër qytezës Kaçanik, pasi që kishin kaluar vendkalimin kufitar në Bllacë, ku mijëra refugjatë shqiptarë janë të strehuar në kamp, e kishte cituar televizioni, ministrinë e brendshme.

Njëri ishte vrarë nga raketa, derisa tjetri ishte qëlluar nga afërsia, brenda veturës së dëmtuar, e cila kishte hyrë në "Jugosllavi", në mënyrë legale, u tha.

Zyrtarët maqedonas nuk e kanë emëruar fajëtorin për këtë sulm.

Trafiku nga Maqedonia në Kosovë, faktikisht ishte ndalur pasi që NATO-ja kishte lansuar fushatën e saj bombarduese kundër "Jugosllavisë", në mars.

Sipas Organizatës Botërore të Ushqimit

# Për Kosovën është siguruar ushqimi për një vit

**Në Kosovën e shkatërruar nga lufta, praktikisht nuk do të ketë të korra sivjet, por një zëdhënëse e Programit Botëror të Ushqimit (WFP) tha se kjo organizatë ka siguruar ushqim për një vit, për të gjithë ata që do të kthehen**

SHKUP, 9 QERSHOR/REUTERS - Zyrtarët e Kombeve të Bashkuara besojnë se do të mund t'u shmangen rreziqeve nga uria e refugjatëve dhe e njerëzve të zhvendosur që do të kthehen në shtëpitë e tyre në Kosovë.

Në Kosovën e shkatërruar nga lufta, praktikisht nuk do të ketë të korra sivjet, por një zëdhënëse e Programit Botëror të Ushqimit (WFP) tha se kjo organizatë ka siguruar ushqim për një vit, për të gjithë ata që do të kthehen.

"Rezervat janë grumbulluar dhe ne besojmë se do t'i kemi të hapura kanalet e shpërndarjes së ushqimit për së paku 12 muaj", deklaroi për Reutersin të mërkurën zyrtarja e WFP-së, Abbi Spring, në një nga shtabet e operimit në kryeqytetin e Maqedonisë.

"Qëllimi kryesor është të sigurohet ushqim i mjaftueshëm që do t'u mundësojë refugjatëve të rindërtojnë jetët e tyre. Ne planifikojmë t'i ushqejmë të gjithë", pohoi ajo.

WFP-ja tashti ka 33.500 tonë ushqim në depot e veta dhe kjo masë do të shtohet në 37.000 deri nga fundi i qershorit, shtoi Spring.

Derisa ajo fliste zyrtarët serbë dhe udhëheqësit ushtarakë të NATO-s mundoheshin të përcaktojnë detajet e tërheqjes së trupave serbe nga Kosova.




Spring po ashtu deklaroi se WFP-ja ka shqyrtuar me kujdes planet lidhur me rrjetin e shpërndarjes së ushqimit nëpër Kosovë. Ky ushqim do të shpërndahet porsa të tërhiqen forcat serbe dhe porsa të japë NATO-ja dritën e gjelbër të sigurisë për të hyrë brenda.

Afro 800.000 refugjatë shqiptarë nga Kosova janë të vendosur në Maqedoninë dhe Shqipërinë fqinje, pasi që ikën nga Kosova kur filluan bombardimet e NATO-s.

Por Spring tha se brengosja më madhe e WFP-së ka të bëjë me kushtet e 600.000 personave të mbetur në Kosovë që janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre e që shumica e tyre janë duke jetuar nëpër male.

"Më së shumti na frikëson situata brenda në Kosovë", theksoi ajo.

Hera e fundit kur WFP-ja ka mundur të shpërndajë ushqim në Prishtinë, kryeqytetin tashmë mjaft të shkatërruar, ka qenë në fund të marsit kur ka siguruar ushqim për 120.000 persona për një muaj.

"Ne nuk kemi mundur të bëjmë diçka që atëherë, por refugjatët që kanë ikur nga Kosova na kanë dhënë një imazh të qartë të kushteve atje", pohoi Spring.

Secili refugjat që do të niset për në Kosovë, nga kampet e Maqedonisë dhe të Shqipërisë do t'i japim ushqim për disa ditë.

Brenda në Kosovë, WFP-ja do të shfrytëzojë helikopterë dhe kamionë për të shkuar edhe jashtë qyteteve të mëdha si edhe do të ndërtojnë qendra për furnizim në rajonet malore.

"Do të ketë nevojë për ne në Kosovë për një kohë të gjatë, me siguri deri në tre vjet", tha Spring.

Ndeshje humanitare për të dëbuarit nga Kosova në Maqedoni

# Sot, luajnë KF "Prishtina" dhe reprezentacioni i Tetovës

**Tashmë në Tetovë kanë arritur të gjithë lojtarët e të dy ekipeve. Formacionet e kompletuara në stadiumin e qytetit kanë filluar stërvitjet, ndërsa organizatorët e ndeshjes njoftojnë se ekziston një interesim i madh**

KOHA Ditore — *BESNIK KAJTAZI*

TETOVË, 12 QERSHOR - Organizuar nga televizioni privat i Tetovës TV KOHA dhe një grup qytetarësh tetovarë, në stadiumin e qytetit në Tetovë, do të organizohet një ndeshje fudbollistike me karakter humanitar ndërmjet ekipit të Prishtinës dhe reprezentacinit të Tetovës. Ndeshja do të zhvillohet sot, të shtunën në orën 17:30, dhe enkas për këtë lojë, nga vende të ndryshme evropiane, në Tetovë kanë ardhur lojtarë të njohur prishtinas. Ndër lojtarë të Prishtinës është edhe ylli i fudbollit kosovar Ardian Kozniku, lojtar i reprezentacionit të Kroacisë që zuri vendin e tretë në Kampinonatin Botëror... të mbajtur vitin e kaluar në Francë, lojtar i tashëm i KF "Croatia" të Zagrebit. Nga Gjermania kanë arritur Kujtim Shala, Isa Sadriu, Harun Isa dhe Muharrem Sahiti, nga Belgjika Gani Llapashtica, kurse nga Kroacia arritën vëllezërit Keçi, Suati dhe Sunaji.

Ndërsa për reprezentacionin e Tetovës do të luajnë lojtarë nga tri ekipe të qyetetit, kurse nga KF "Slloga" ka arritur ylli i futbollit shqiptar në Maqedoni Nebih Mustafa. Sipas selektorit të reprezentacioni të Tetovës, Haqim Mehmeti, kjo ndeshje do të jetë një spektakël i paharueshëm për futbolldashësit, si nga Tetova ashtu edhe nga viset e tjera të Maqedonisë Perëndimore dhe Kosovës, rezultati përfundimtar i së cilës nuk do të jetë fare i rëndësishëm. Për Mehmetin mjafton që loja të jetë cilësore dhe që shikuesit e shumtë që priten në stadiumin e qytetit të jenë të kënaqur.

Tashmë në Tetovë kanë arritur të gjithë lojtarët e të dy ekipeve. Formacionet e kompletuara në stadiumin e qytetit kanë filluar stërvitjet, ndërsa organizatorët e ndeshjes njoftojnë se ekziston një interesim i madh.

Në shitje ishin lëshuar 10.000 bileta dhe të gjitha të hollat nga ndeshja do t'i dorëzohen organizatës humanitare "El Hilal" nga Tetova, nga e cila në formë të ndihmës do t'u shpërndahen të dëbuarve nga Kosova.

Për Prishtinën do të luajnë: Ardian Kozniku, Kujtim Shala, Harun Isa, Isa Sadriu, Gani Llapashtica, Sunaj Keçi, Suad Keçi, Muharrem Sahiti, Arbnor Morina, Afrim Tovërlani, Adil Vokri, Arsim Abazi, Erxhan Menga, Xhemail Zeqiri, Milaim Humolli dhe Visar Aliu. Selektor është Ajet Shosholli, ndërsa trajner Jusuf Tortoshi.

Për reprezentacionin e Tetovës pritet të luajnë Ardian Hoxha, Samet Zendeli, Lirim Sahiti, Bekim Osmani, Jove Bozinovske, Evzad Jahiu, Ivica Jovanosvki, Halim Modaje, Skënder Jonuzi, Qatip Osmani, Ylber Aliu, Festim Ademi, Rexhep Qamili dhe Berat Ymeri.

Selektorë të reprezentacionit të Tetovës janë: Haqim Mehmeti dhe Steve Zakovski.

Nga kryeqyteti i botës

# A do të mbijetojë Milosheviqi?

**Edhe pse me finokërinë e tij të zakonshme, fshikatarinë dhe pamëshirësinë, Milosheviqi e mbijetoi luftën, ka shumë pak gjasa që ai ta mbijetojë paqen tashti**

*JANUSZ BUGAJSKI*

Serbia e ka humbur luftën me NATO-n pavarësisht nga propagimet e kundërta. Milosheviqi i çoi duart për shkak të presioneve nga brenda dhe jashtë. Edhe pse me finokërinë e tij të zakonshme, fshikatarinë dhe pamëshirësinë, Milosheviqi e mbijetoi luftën, ka shumë pak gjasa që ai ta mbijetojë paqen tashti. Bombardimet e NATO-s sheshazi kanë qenë më të suksesshme se sa që e pranon Beogradi apo se sa që pohojnë disa skeptikë të Perëndimit. Dy muaj të sulmeve të intensifikuara me municion preciz kanë shkatërruar më se një të tretën e "harduerit" të ushtrisë së Jugosllavisë. Janë gjymtyar infrastruktura e shtetit, komunikimet, industria, burimet energjetike, të cilat e kanë shtyrë Serbinë edhe më thellë në humbëtirën ekonomike. Po të ishin sulmet intensive që nga fillimi, Beogradi do t'i ishte nënshtruar Aleancës... që para një muaji. Në vend të kësaj, politikanët e NATO-s bënin sehir duke pritur që Milosheviqi më parë do ta kuptojë forcën selektive se sa fuqinë mbizotëruese. Beogradi më së shumti i frikësohej një ofensive të këmbësorisë së NATO-s, e cila shumë shpejt do të kishte çliruar Kosovën. Eprorët e çështjeve teknike dhe profesioniste të NATO-s do ta kishin gjymtuar ushtrinë e Jugosllavisë dhe policinë e Serbisë.

Derisa aleanca po përforconte forcat e saj në rajon, gjeneralët e Milosheviqit u bindën se NATO-ja ishte duke u përgatitur që të invadonte, pavarësisht nga mohimet që i bënte. Pushtimi dhe okupimi do ta kishin eliminuar çdo pretekst që Beogradi ta mbajë Kosovën nën kontroll. Humbja e përnjëhershme e Kosovës do ta kishte dërrmuar fare legjitimitetin e regjimit dhe do të kishte nxitur beteja përbrenda Serbisë.

Frika e thyerjes së brendshme e ka bindur Milosheviqin që të përpiqet dhe ta bëjë që dorëzimin ta shndërrojë në kompromis. Numri i shtuar i dezertimeve, ikjet që priteshin dhe morali i humbur filluan të ndikonin në dishiplinën ushtarake dhe i ndihmuan sukseseve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mijëra ushtarë serbë janë flijuar gjatë bombardimeve të NATO-s dhe aksioneve të suksesshme të UÇK-së gjatë javëve të fundit. Forcat jugosllave ishin në rrezik që të humbin kontrollin mbi pjesë të mëdha të territorit.

Humbjet ushtarake, njëherit, nxitën edhe trazira në disa qytete të Serbisë. Demonstrata kundër luftës kërcënonin që të shndërroheshin në marshe kundër regjimit. Elita e Beogradit i frikësohej një vale trazirash civile në shenjë proteste kundër mungesës së karburantëve dhe të ushqimit si dhe kundër vdekjes së të rinjëve që shërbenin në Kosovë. Pakuptimësia e strategjisë së Milosheviqit filloi të dalë në shesh në shumë sektorë publikë.

Kësisoji, pa pritur këtë shpërthim të brendshëm, Milosheviqi bëri hesap se dorëzimi, i bërë ashtu që të duket se është marrëveshje, do të bënte që ai ta zgjasë edhe ca qëndrimin në pushtet. Për ta sigyruar një përfundim të tillë, cari serb do të provojë lloj-lloj truqesh për të hutuar dhe mashtruar komunitetin ndërkombëtar. Beogradi do të bëjë përpjekje që të zbusë kushtet ushtarake të NATO-s duke mbajtur edhe më tej ca ushtarë në Kosovë, posaçërisht, përgjatë kufirit, ku ata do të mund të kontrollonin një numër të të deportuarve shqiptarë që kthehen në shtëpi. Serbia, poashtu, do të vendos forcat e tërhequra përgjatë perimetrit të Kosovës dhe do të mundohet që të hyjë në Mal të Zi. Gjeneralët shpresojnë se ndërprerja e bombardimeve të NATO-s do t'u mundësojë që të rigrupohen dhe t'i konsolidojnë radhët.

Poende, propaganda serbe do ta paraqesë kontrollin e NATO-s në Kosovë si operacion paqembajtës të OKB-së të disenjuar për ta rindërtuar krahinën, për t'i çarmatosur "terroristët shqiptarë" dhe për t'i garantuar Serbisë integritetin territorial. Të përballur me mëdyshje dhe përçarje, liderët e aleancës duhet të mbeten të vendosur për ta realizuar implementimin e pesë kushteve për Kosovën. Pa e respektuar mandatin e OKB-së dhe pjesëmarrjen eventuale të Rusisë, NATO-ja duhet t'i shmanget disfatës brenda në Kosovë. Në të vërtetë, suksesi, jo vetëm që do të sigurojë kthimin e shumicës së shqiptarëve, por edhe do t'ia shkurtojë ditët në koltuk Milosheviqit. Zhbërja e "pastrimit etnik" (që nuk është realizuar plotësisht në Bosnjë), rekonstruktimi ekonomik i Kosovës dhe krijimi i institucioneve protodemokratike nën ombrellën e OSBE-së, do ta zgjerojnë dukshëm grykën midis Kosovës dhe Serbisë. Rindërtimi i Malit të Zi neutral edhe më tej do ta shpejtojë procesin e izolimit të Serbisë.

Gjatë javëve që vijnë, Milosheviqi do t'i kundërvihet një vargu të problemeve shpërthyese: skamja ekonomike, kthimin e ushtarëve dhe oficerëve të hidhëruar dhe me valën e refugjatëve serbë nga Kosova. Edhe opozita politike e vendit do të mund të trimërohej. Derisa ultranacionalistët do ta shpallin Milosheviqin tradhëtar, për shkak të humbjes së Kosovës, kuazidemokratët do ta akuzojnë se e ka shtyrë vendin në skamje dhe izolim.

I përballur me rënien politike, Milosheviqit do t'i mbeten dy opcione - dorëheqja apo lufta deri në fund. Dorëheqja ka më pak gjaas, sepse ai nuk ka ku të shkojë. Jashtë Serbisë, ai është një kriminel i paditur, i kërkuar, ndërsa brenda në Serbi ai do të mund tëdilte para gjyqit ushtarak për tradëti kombëtare dhe të ekzekutohet nga gjeneralët e tij, siç i ka ndodhur Çausheskut në Rumuni.

Vetëm rënia e regjimit të Milosheviqit mund ta shpëtojë Serbinë nga dezintegrimi i mëtutjeshëm dhe kaosi, duke i premtuar përpjekje të rikonstruktimit rajonal. Mirëpo, kolapsi do të mund të ishte i përgjakshëm dhe i shtrenjtë, nëse Milosheviqi vendos që të luftojë deri në fundin e hidhur. Trazirat civile do të mund të eskalonin shumë shpejt në një luftë civile ku do të kacafyteshin njësitë ushtarake të Jugosllavisë kundër policisë paramilitare, lojale Milosheviqit ose milicive rivale të partive të ndryshme. Derisa zëvendësimi paqesor i regjimit të tanishëm është zgjidhja më optimiste, verzioni i dhunshëm duke më i mundshëm.

Zgjidhja më e dëmshme, si për Serbinë ashtu edhe për rajonin është mbijetesa e Milosheviqit. Jo vetëm që Serbia do të zhytej në errësirën ekonomike, por edhe Milosheviqi do të provojë të knjojë konflikte të reja në Mal të Zi, Vojvodinë apo Sanxhak, për ta tërhequr vërejtjen nga skamja dhe izolimi ekonomik.

Roli i Rusisë në këtë dramë do të duhej që të analizohej nga demokracitë e Perëndimit. Edhe pse Rusia, pa mëdyshje, ka nënshkruar kushtet e NATO-s për Kosovën, qëllimet e saj në Ballkan janë diametralisht të kundërta me ato të Aleancës...

Rusia dëshiron që ta mbaj në pushtet aleatin e saj të fundit në rajon dhe ta mbaj Jugosllavinë ekzistuese, në mënyrë që të pengohet nxitja e secesionizmit në federatën e dështuar të Rusisë.

Para së gjithash, Moska kundërshton me të madhe hyrjen e NATO-s në Ballkan dhe përpiqet që të sterilizojë vendosjen e KFOR-it. Sëkëndjemi, suksesi i Aleancës... nuk është kritike vetëm për stabilitetin në rajon, por edhe për të ardhmen e NATO-s si sovran i sigurisë në Evropë.

Karikaturisti ynë Jeton Mikullovci - JEMI - përsëri me Ju



Autor: Jeton Mikullovci

KOHA Ditore
www.kohaditore.com
E përditshme e pavarur informative • Fahu postar 202 • Botues: Veton SURROI • Kryeredaktor: Baton HAXHIU, zv. Kryeredaktor: Agron BAJRAMI, redaktor përgjegjës: Ardian ARIFAJ.
Drejtor: Luan DOBROSHI • Telefonat e redaksisë: 038/22-432; 28-488, 24-655 dhe 28-480 • Fax: 038/25-540 • e-mail: redaksia@kohaditore.com • Telefoni i marketingut: 038/27-570 • Xhirollogaria: 48400-601-2-41203
Shtypet në Shtypshkronjën "KOHA" • tel.: 038/44-373
Koha Ditore - botimi ndërkombëtar: K.D.Press GmbH, Steinenvorstadt 60, 4051 Basel Schweiz • Tel.: ++41/61/283/2015 • Fax: ++41/61/283/2019; për njoftime: ++41/61/283/2017 Marketingu: ++41/61/283/2016, mob. tel.: ++41/79/667/9925 • e-mail: koha@magnet.ch • KD Press Post cont. 40-4614-0; 233-555.343.01W UBS 4123 Allschwill CH conto-nr. (D): Postbank Niederlassung Karlsruhe, K.D.Press GmbH, K.N. 359333-755, Bankleitzahl 66010075 Druck: Multipress, Frankfurt D • Doreshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen.

"Berliner Zeitung"

# Kosovarët: "William Walker – është hero yni"



**Diplomati amerikan 55-vjeçar kishte ngjallur, sidomos pakënaqësinë e delegacionit rus në OSBE, sipas shijes së të cilëve ai si tepër i afrohej linjës së NATO-s. Veçanërisht të zemëruar rusët kishin reaguar kur Walker, gjatë muajit janar, pas gjetjes së 45 shqiptarëve të vrarë në fshatin Reçak, spontanisht foli për për një masakër të forcave të rregullta policore**

NORBERT MAPPES-NIEDIEK

Disa qindra refugjatë shqiptarë rrethuan të mërkurën në Kampin e Stenkovecit një xhip të OSBE-së. Minutë pas minute dikush sillte në automjet një listë të mbushur me nënshkrime. Pasdite madje u zhvilluan protesta – ngjarje të tilla në kampin e refugjatëve gjithnjë e vënë në alarm policinë maqedonase. Arsye për protestë ishte lajmi se shefi i popullarizuar ndër shqiptarë i Misionit të OSBE-së, amerikani William Walker ishte hequr nga detyra.

"Walker është hero yni!", tha një punëtore shqiptare e OSBE-së, e cila mblidhte listat. "Duam që ta kthejnë!" Të martën në mbrëmje Këshilli i përhershëm i OSBE-së në Vjenë kishte vendosur që shpërndahet Misioni Verifikues..., i cili pas fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s ishte vendosur në Maqedoni. Nën emrin "Transitional Task Force" (TTF) u themelua një grup i posaçëm për kalimin në një mision të ri. Mirëpo, TTF nuk do të udhëhiqet nga William Walkeri, por nga norvegjezi Tore Bögh. Misioni i ri është planifikuar për rastin në qoftë se OSBE-së i jepet mandati që, pas marshimit të trupave të NATO-s, në Kosovë të marrë mbi vete organizimin e admnistratës civile. Nëpunësit janë të njëjtë, si detyrë të re kryesuesi i OSBE-së dhe ministri norvegjez i Punëve të Jashtme, Knut Vollebaek, ringritjen e sistemit juridik, rindërtimin e administratës dhe përgatitjen e zgjedhjeve. Misioni i deritashëm së fundi para së gjithash ishte i angazhuar në mbledhjen e njoftimeve për zhvillimet në Kosovë dhe të mbajë kontakt me politikanët kosovarë.

### Kundër vullnetit të SHBA-së

Sipas njoftimeve të diplomatëve në Vjenë shkak i vërtetë i ridefinimit të mandatit është se në këtë mënyrë heqet Walkeri "problematik", pa u përjashtuar formalisht nga detyra. Diplomati amerikan 55-vjeçar kishte ngjallur, sidomos pakënaqësinë e delegacionit rus në OSBE, sipas shijes së të cilëve ai si tepër i afrohej linjës së NATO-s. Veçanërisht të zemëruar rusët kishin reaguar kur Walker, gjatë muajit janar, pas gjetjes së 45 shqiptarëve të vrarë në fshatin Reçak, spontanisht foli për për një masakër të forcave të rregullta policore. Evropianët perëndimorë në këtë pozitë më me dëshirë do të kishin parë një diplomat evropian; kështu interesat e tyre përputheshin me ato ruse. Vendimin për ridefinimin e Misionit të OSBE-së Vollebaek e mori kundër vullnetit të SHBA-së. Komplikime të tjera solli para së gjithash mënyra e veprimit të tij. Derisa Walker gjendej në pushime, Vollabaek paralajmëroi ndërrimin e tij javën e kaluar gjatë një konference shtypi. Për vendimin definitiv misioni i OSBE-së në Shkup u njoftua nëpërmjet një faksi të shkurtër. Refugjatët shqiptarë, të cilët kanë besim të madh në Walkerin, nuk u njoftuan për këtë. Midis tyre qarkullonte lajmi jo aq i pasaktë se "rusët" nuk dëshironin që Walker të mbajë funksionin.

(E.R.)

IWPR: Koment i një kolumnisti anonim serb:

# Edhe një luftë e humbur jona

**Serbia ka triumfuar, kurse OKB-ja është shtyrë të hyjë në Kosovë. Gas nuk kemi, por do të na ngrohë dashuria për kryetarin tonë**

Pikërisht 11 javë pas fillimit të vizitës spektakulare të NATO-s në Serbi, lufta ajrore kundër këtij shteti të vogël, të varfër dhe tolerant, mbaroi më në fund, theksoi Radio Televizioni i Serbisë (RTS). Lajmi u dëgjua vetëm në edicionin tretë, të mërkurën, më 9 qershor, rreth orës 22:30. Folësja e televizionit, një grua, ia filloi të buzëqesh. Pastaj, mbylli një sy. Pastaj, buzëqeshi sërish. Duke bërë flert me publikun, ajo nuk mund ta fshihte atë që, pa dyshim, i ishte urdhëruar nga padronët, Partia në pushtet, Socialiste e Serbisë. Bombardimet, tha ajo, janë ndërprerë. Politika e paqes e Serbisë dhe e kryetarit tonë, Slobodan Milosheviqit ka triumfuar. E gjitha ka marrë fund, ne fituam dhe s'ka ku të shkojë më mirë.

Ushtria heroike e Jugosllavisë, informon RTS-ja, është duke u kthyer fitimtare nga Kosova, derisa trupat fashiste të Rendit të Ri Botëror po hyjnë si qyqarë në trojet e shenjta serbe. Kjo është më shumë se fitore, shpjegonte fytyra sharmante, kjo është katarzë, nirvanë. Kjo, dëgjues të nderuar, është orgazëm. Është e sigurtë, të gjithë dëgjuesit do të mund të gëzohen që 2.5 tonë bomba më nuk do të bien mbi shtëpitë tona. Dhe jo vetëm kaq: tashti do të flemë zbathur - dhe në ëndrrat tona do t'i falenderohemi kryetarit tonë, Slobodan Milosheviq, i cili na ka mbrojtur personalisht 77 ditë të tëra. Çka ka lidhje që pesë a gjashtë, apo shtatë e tetë e nëntë apo edhe dhjetë mijë ushtarë e civilë kanë vdekur? Se, a di si, OKB-ja është në Kosovë. Ju spanjollë, anglezë, francezë, gjermanë, amerikanë - ne këtë e kemi dashur që nga fillimi. Ju na jeni nevojitur të na forconi sovranitetin e Republikës Federative të Jugosllavisë. Dhe, zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Nebojsha Vujoviqi na përkujtoi që ata na janë nevojitur për t'u ndihmuar shqiptarëve që të kthehen nëpër shtëpi, ku do të jetojnë të lumtur me ne. E ku kemi qenë ne ndërkohë? Askund. Çka bënim ne? Asgjë.

Kujt ia ndien? Vetëm disa minuta pas fjalimit në TV, Beogradi shpërtheu me të shtëna automatiku, kalashnjikovësh dhe uzish. Qytetarët e dashuruar në Slobodan Milosheviqin, menjëherë e shprehën besimin në fitore, duke demonstruar me artileri të lehtë dhe bomba. Shtienin për të shprehur dashurinë e tyre ndaj projektit paqesor që ia kemi imponuar forcave të NATO-s. Grafiti i famshëm i Leskovcit, përnjëherësh u bë realitet: "Dorëzohu NATO! Se ne po vdesim".

Po, çka jemi duke kremtuar në të vërtetë? Merre veturën (nëse ke benzinë) dhe nuk do të mund të shkosh në Valevë, Uzhicë e Nish. Ne jug e veri, të gjitha janë shkatërruar. Nuk ekzistojnë më urat, rrugët më nuk janë, sistemi energjetik e ka pasur dhe rryma elektrike është ndërprerë. I tërë vendi është një gërmadhë: me tjegulla, suva, copa xhami. Bombat na çuan posht'.

Ekonomi më nuk ka. Optimistët thonë se 3 milionë njerëz kanë mbetur të papunë, ndërkaq pesimistët e shtojnë edhe një milion tjetër. Postat më nuk funksionojnë, gazetat u ngjajnë bilteneve të fashistëve, gjendja e luftës nuk është hequr. Po, ç'luan rol kjo në krahasim me faktin se politika e kryetarit tona ka fituar? A nuk është "seksi" të vdesim etjeje, duke e ditur se e kemi bërë budalla NATO-n? Që tashti na bie ndërmend dimri, kur nuk do të kemi gas, as nxemje. Që tashti jam duke e shikuar si perverz tepihun tim dhe po mendoj: në cilën anë do të filloj ta djeg aty nga janari, rreth ditëlindjes sime? Nuk na ka mbetur tjetër që të na nxeh, pos dashurisë për kryetarin tonë dhe për Kosovën. Ushtria jonë po kthehet nga Kosova në vend pa asnjë ndërtesë ushtarake të mbetur qirithi. Ushtarë të nervozuar, të hidhëruar e të dëshpëruar që 77 ditë me radhë janë lutur që të mos goditen nga hedhurinat e NATO-s — ku do të shkojnë ata tashti? Do t'i ftojmë nëpër shtëpitë tona që ta organizojmë mbrojtjen tonë territoriale nga dritaret e katëve më të larta të banesave tona. Të shtënat e natës janë të tmerrshme — bëjnë më pak zhurmë, por janë më kaotike (dhe përmbajnë më shumë alkool) se ato të NATO-s. Mirëpo, mëngjesi është me të vërtetë i llahtarshëm. Radiot lëshojnë muzikë të gjytyrymëve, kurse gazetat të bëjnë të vjellësh me raportet e paqes. Askush nuk i përmend të vrarët, të zhdukurit dhe trupat e shkatërruara. Dielli ka mbetur po ai. Qielli i kaltërt, siç ka qenë. Mirëpo, humori është gri - disfata, poshtërimi, edhe një gradë në kartën e raporteve të luftës të nxënësit Milosheviq. Edhe një luftë e humbur jona.

Kjo luftë 77 ditëshe është krijuar për t'u humbur. Fundi i saj tregon: lumturia e këtij çasti mbulon sukseset e madhërishme të regjimit. Kush do t'i kujtojë tashti kohët kur rroga 20 markëshe do të duket mrekulli, kur pamjet e shtëpive të shkatërruara, spitaleve dhe fabrikave të na japin forcë morale?

Askush nga ne nuk i ka dëgjuar deklaratat e Perëndimit se Serbia nuk do të marrë ndihmë financiare, përderisa Milosheviqi të mbetet në pushtet. Të helmuar nga paqja, nga mjeshtëritë e kryetarit tonë dhe nga raportet se e kemi mbrojtur Kosovën, ne, zombit e Jugosllavisë, e dimë se jemi më të mirët, më të fortët, më të mençurit - hyjnorët. Vetëm lypsen edhe disa shekuj që këtë edhe të tjerët ta pranojnë. Mirupafshim në luftën e ardhshme!

*(Autori është një kolumnist i shquar beogradas, i cili ka preferuar të mbetet anonim, ndërsa komenti është botuar në buletinin e organizatës joqeveritare "International War and Peace Reporting" në Londër)*

Karikatura "Chicago Tribune"



"The New

# Tani pavarësia

**Njerëzit që jetojnë në Kosovë nuk do të shërbejnë në Armatën jugosllave e as që do t'i paguajnë taksa "RFJ"-së; një forcë e re policore dhe një sistem i ri juridik do të ndërtohet, pa influencë fare nga Serbia; valutë zyrtare do të jetë ose marka gjermane ose dollari amerikan, ndërsa tregtia do të orientohet kah jugu - kah Shqipëria, Maqedonia si dhe Mali i Zi, në vend se kah Serbia**

*JANE PERLEZ*

KÖLN, GJERMANI - Edhe pse e ardhmja politike e Kosovës është lënë pa u zgjidhur në marrëveshjen që i dha fund luftës, zyrtarët e NATO-s dhe ata amerikanë thonë se parashohin një protektorat ndërkombëtar për Kosovën, që në teori do ta lënte atë pjesë të "RFJ"-së, por që pas disa vjetësh, shumë lehtë do të shndërrohej në pavarësi.

Derisa refugjatët kthehen dhe shoqëria ndërtohet, thotë një zyrtar i NATO-s, Kosova do të "ngrisë gardh" mes saj e Jugosllavisë. Njerëzit që jetojnë në Kosovë nuk do të shërbejnë në Armatën jugosllave e as që do t'i paguajnë taksa "RFJ"-së; një forcë e re policore dhe një sistem i ri juridik do të ndërtohet, pa influencë fare nga Serbia; valutë zyrtare do të jetë ose marka gjermane ose dollari amerikan, ndërsa tregtia do të orientohet kah jugu - kah Shqipëria, Maqedonia si dhe Mali i Zi, në vend se kah Serbia.

Asnjë nga këto pika, megjithatë, nuk është përmendur në vendimin që e ka pranuar Milosheviqi. Në të vërtetë, në përpilimin e zgjidhjes politike për luftën, aleatët në NATO ishin të kujdesshëm që të nënvizojnë se Kosova do të mbetet brenda Jugosllavisë.

Vurja e theksit në ruajtjen e integritetit territorial të Jugosllavisë dhe moslejimin e Kosovës që të ndahet menjëherë, ishte mëlmesa esenciale në përfitimin e Milosheviqit dhe të rusëve që të pranojnë marrëveshjen. Edhe evroperëndimorët janë në përgjithësi të kujdesshëm kur është fjala për pasojat që do të kishte për kontinentin ndarja e Kosovës nga "RFJ".

Por, rezoluta e miratuar në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përfshin paragrafin "duke marrë parasysh në tërësi marrëveshjen e Rambouillet", një sinjal që do të mund të interpretohej thotë se në fund të rrugëtimit, pavarësia është një nga mundësitë, thonë zyrtarë të ndryshëm.

Në marrëveshjen e Rambouilliet - të cilën Milosheviqi refuzoi ta nënshkruajë, gjë që solli edhe bombardimet - statusi i ardhshëm i Kosovës do të duhej të vendosej në një konferencë ndëkombëtare pas tri vjetësh. Pikëpamjet e konferencës, "vullneti i popullit të Kosovës" si dhe pikëpamjet e serbëve do të përcaktonin statusin final të provincës.

Marrëveshja ofronte një plan të detajizuar për një Kosovë autonome, me një parlament me 120 vende, rregullat e zgjedhjeve, sistem të pavarur juridik, struktura qeverisëse lokale, forcë policore dhe sigurim të kufirit.

Nën planin e miratuar këtë javë, Kosova do të jetë krejtësisht e ndarë nga Serbia, republikë dominante në Jugosllavinë e mbetur.





# York Times"

# është edhe më afër

dhe gjasët që serbët të kenë rol të dukshëm në statusin e Kosovës janë zbehur krejtësisht, thonë zyrtarët.
Rikonstruktimi fizik i Kosovës është shqyrtuar në takimin në Köln, të G-8, dhe u tha se së shpejti do të organizohet një konferencë e donatorëve potencialë për të filluar grumbullimin e miliarda dollarëve të nevojshëm për këtë detyrë.
Ministrat e jashtëm të G-8-shës përpiluan edhe Paktin e stabilitetit për Evropën Juglindore që do të ndihmojë ekonomitë edhe ashtu të varfëra të goditura edhe më nga lufta. Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar do të ftohen të ndihmojnë.
Të enjtën, kryetari Clinton është shprehur se për shkak se SHBA-ja ka bartur barrën kryesore të fushatës ajrore, llogaria për ndërtimin e shtëpive të djegura, rrugëve të shkatërruara dhe shkollave të bëra rrafsh me tokë, do të paguhet kryesisht nga Bashkësia Evropiane.
Administrata e Clintonit ka kërkuar 100 milionë dollarë shtesë për Kosovën dhe rizhvillimin e rajonit, por pritet që Kongresi amerikan të miratojë vetëm një pjesë të kësaj shume.
Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan, pritet që së shpejti të emërojë përfaqësuesin e posaçëm të Organizatës botërore për Kosovën, një post që do të jetë diç si i Guvernatorit të Përgjithsëm.
Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme franceze, Anne Gazeau-Secret, ka thënë të enjtën se qeveria e saj ka kërkuar që Annan të emërojë në atë post një evropian. Kjo do të ishte gjë e lakmueshme, pasiqë, siç tha ajo, pjesa më e madhe e parave për rikonstruktim vjen nga vendet e Bashkësisë Evropiane. Zyrtarë të administratës së Clintonit kanë thënë se, përkundër dyshimeve në efikasitetin e programeve të KB-së, ata janë të vendosur që të lejojnë KB-në të marrë përgjegjësinë e plotë mbi Kosovë, duke lënë BE-në të marrë rolin kryesor si finansues.
Kombet e Bashkuara ka qenë organizata më e preferuar si lojtari kyç, thonë zyrtarët, sepse Shtetet e Bashkuara kanë influencë në të, por jo edhe në BE.
Një organizatë tjetër, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, organizata me 54 anëtarë e me seli në Vjenë, do të luajë po ashtu një rol qendror në rindërtimin e Kosovës, thonë zyrtarët. Në veçanti, ajo do të organizojë zgjedhjet si dhe do të mund të ndihmonte në formimin e forcave policore.
Në muajt e fundit, administrata e Clintonit ka qenë e kujdesshme që të mos e përjashtojë më pavarësinë e Kosovës si opcion i mundshëm, edhe pse vendet e Evropës janë më të kujdesshme rreth kësaj ideje.
Si pyetje morale, mundësia e arritjes së pavarësisë është gjë e rëndësishme për shqiptarët e Kosovës, të cilët përbëjnë 90 për qind të popullatës. Ekspertët e Ballkanit thonë se shumica e sebrëve që ende jetojnë në Kosovë, shumë shpejt do të shpërngulen për në Serbi, duke ua lënë Kosovën tërësisht shqiptarëve.
Për Evropën Perëndimore, Kosova e pavarur, ose një Kosovë e bashkuar me Shqipërinë, është ide më pak e pranueshme, se sa që është për Shtetet e Bashkuara, janë të mendimit diplomatë evropianë.
E para, thonë këta, ndarja e Kosovës nga "RFJ" do të ishte shembull për grupet tjera separatiste në Evropë. Faktor i dytë, më pak i përmendur, është frika që Kosova, popullata e së cilës është kryesisht myslimane, të bëhet një vend islamik në vet Evropën.
Derisa përgatitjet për rindërtimin e Kosovës janë në rrugë e sipër, tani përkujtohet shpesh angazhimi në Bosnjë, pas paqes së arritur më 1995. Sipas shumë vlerësimeve, rindërtimi i Bosnjës është penguar nga menaxhmenti i dobët, garat mes organizatave ndërkombëtare si dhe nga ardhja e ngadalësuar e fondeve nga Bashkësia Evropiane.





